

Shejhul Islam Ibn Tejmije

EL UBUDIJE

العُبُودِيَّةُ

Autor:

Ahmed ibn Abdulhalim ibn Tejmije

Titulli në origjinal:

الْعُبُودِيَّة

Titulli në shqip:

El Ubudije (adhurimi)

Përktheu nga arabishtja:

Mazllam Mazllami

Krahasoi me origjinalin:

Hekuran Helshani

Shtypi:

Shtypshkronja Graf-ing

Prishtinë

2022

Me Emrin e Allahut, Mëshirëplotit, Mëshiruesit!

Parathënie

Të gjitha lavdërimet i përkasin Allahut, kurse pagja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Pejgamberin ,ﷺ familjet dhe shokët e tij, dhe mbi të gjithë ata që e pasojnë atë, deri në Ditën e Gjykimit!

E, më pas, libri që keni në duar përmban disa pjesë të zgjedhura nga libri "El ubudije", i shkruar nga kolosi i dijes Islame, shejhul-Islam Ahmed ibn Abdulhalim Ibn Tejmije – Allahu e mëshiroftë! – i cili ka lindur në vitin 661 sipas hixhretit, dhe ka vdekur në vitin 728 h, dhe i cili ka lënë pas vetes trashëgimi të paparë në fushën e diturisë Islame, në të gjithë degët e fesë.

Fjala “el ubudije”, në gjuhën shqipe ka një kuptim më të gjerë sesa thjeshtë adhurim, pasi që adhurimi quhet “ibadet” në gjuhën arabe, mirëpo këtu është për qëllim aspekti më i gjerë adhurimit të njeriut që lidhet drejtpërdrejt me veprat e zemrës si: dashuria, frika, shpresa, kërkimi i ndihmës dhe mbështetja tek Allahu Fuqiplotë.

E lusim Allahun që të na bëjë dobi me përkthimin e këtij libërthi, dhe njëkohësisht shpresojmë që edhe lexuesi, pasi ta ketë lexuar vetë librin, të tregohet bujar duke e shpërndarë atë tek të tjerët.

Mazllam Mazllami

4.8.1994

Prizren

Lavd i qoftë Allahut të Lartësuar - Kujdestarit të gjithësisë -, lavde të shumta e të bekuara, ashtu siç do Zoti i Madhërishëm dhe është i kënaqur! Pastaj salavati¹ qoftë për të zgjedhurin e të gjitha krijesave të Zotit, vulën e pejgamberëve, Muhamedin², rob dhe i dërguar i Tij, si dhe mbi familjen e tij të cilët i besuan, e përkrahën dhe ndihmuan, si dhe pasuan dritën e zbritur mbi të!

Dijetari i madh i Islamit (Shejhul Islami), kolosi i dijetarëve, ndihmëtari i hadithit e shkatërruesi i bidatit³, Ahmed ibn Abdulhalim ibn Tejmije, në lidhje me Fjalën e Allahut:

{ يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ ... }

“O ju njerëz, adhurojeni Zotin tuaj...” [Bekare, 21]

U pyet: “Çfarë është adhurimi? Cilat janë degët e tij? A përfshihet e tërë feja në të apo jo? Cila është esenca e ibadetit (adhurimit)? A është adhurimi pozita më e lartë (piedestali) në dynja dhe në ahiret? Apo mos ekziston diçka më e lartë?”

Në vijim, ai (Allahu e mëshiroftë!) u përgjigj:

*El hamdu lilahi rabbil alemin!*⁴

Fjala ibadet është një term përmbledhës që në vete përmban çdo fjalë apo vepër, të dukshme apo të padukshme, të cilat Allahu i do dhe me të cilat është i Kënaqur, siç janë:

¹ Salavat: Përhëndetjet dhe lavdërimet e Allahut të Madhërishëm dhe melekëve të Tij për Pejgamberin Muhamed.

² Në vijim do të përdoret ky simbol (ﷺ) sa herë që dërgojmë salavat për Muhamedin, apo për pejgamberët e tjerë.

³ Bidat (risi): Çdo fjalë, vepër apo besim (kredo) përmes të cilit njeriu synon afrimin tek Allahu i Lartësuar, e që për të s’ka argument nga sheriat.

⁴ Të gjitha lavdërimet qofshin për Allahun, Zotin e botëve!

Namazi, zeqati, agjërimi, haxhi, sinqeriteti në të folur, besnikëria, respektimi i prindërve, lidhjet farefisnore, mbajtja e besës, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, xhihadi kundër jobesimtarëve e hipokritëve, bamirësia ndaj fqiu, bonjakut, të varfrit, udhëtarit e robërve, gjegjësisht edhe bamirësia ndaj kafshëve sikurse ndaj njerëzve; pastaj lutja, përmendja e Allahut (dhikri), leximi i Kuranit dhe simotrat e këtyre;

Po ashtu, dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ frika nga Allahu, mbështetja tek Ai, përkushtimi i sinqertë në fenë e Tij, sabri (durimi) në atë që Ai ka caktuar, falënderimi për begatitë e Tij, kënaqësia me gjykimin e Tij, mbështetja në Të, shpresa për rahmetin e Tij, frika nga dënimi i Tij, e të ngjashme me këto; Të gjitha këto me një fjalë quhen ibadet dhe bëhen vetëm për Allahun e Lartësuar.

Pra, ibadeti për Allahun e Madhëruar është qëllimi final të cilin Ai e dëshiron, me të cilin është i Kënaqur për krijesën e Tij (njeriun), madje për këtë arsye i ka krijuar krijesat, siç ka thënë i Lartësuari:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾

“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” [Dharijat, 56]

Me këtë mision (detyrë) janë dërguar edhe të gjithë peygamberët e tjerë. Siç i tha edhe Nuhu popullit të vet:

﴿يَقَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ﴾

“O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij!” [Arafë, 59]

Të njëjtat fjalë ua thanë popullit të vet edhe Hudi, Salihu, Shuajbi dhe të tjerët (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ta).

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ فَمِنْهُمْ مَنْ هَدَى اللَّهُ وَمِنْهُمْ مَنْ حَقَّتْ عَلَيْهِ الضَّلَالَةُ فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكْذِبِينَ﴾

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt (tagutin)!” Disa prej tyre Allahu i shpuri në rrugë të drejtë e disa e merituan të mbeten në humbje. Andaj, udhëtoni nëpër botë të shihni se si ishte fundi i përgënjeshtresve!” [Nahl, 36]

I Lartësuari po ashtu ka thënë:

﴿وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رَسُولٍ إِلَّا نُوحِي إِلَيْهِ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدُونِ﴾

“Ne nuk kemi dërguar asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: “S’ka të adhuruar të denjë përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!” [Enbija, 25]

E në të njëjtën sure, në ajetin 92, Allahu thotë:

﴿إِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاعْبُدُونِ﴾

“Vërtet, ky është besimi juaj - besimi i vetëm, e Unë jam Zoti juaj, andaj më adhuroni Mua!”

Siç ka thënë edhe në ajetet tjera:

﴿يَا أَيُّهَا الرُّسُلُ كُلُوا مِنَ الطَّيِّبَاتِ وَاعْمَلُوا صَالِحًا إِنِّي بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ ﴿٥١﴾ وَإِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاتَّقُونِ﴾

“O të dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira! Vërtet, Unë e di mirë çfarë bëni ju! Vërtet, kjo feja juaj është një fe e vetme, ndërsa Unë jam Zoti juaj, andaj frikësohuni prej Meje!” [Mu’minunë, 51-52]

Madje, Allahu e ka kërkuar këtë gjë nga Pejgamberi ynë ﷺ pashmangshëm deri në vdekje. Allahu thotë:

﴿وَاعْبُدْ رَبَّكَ حَتَّىٰ يَأْتِيَكَ الْيَقِينُ﴾

“Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” [Hixhër, 99]

Allahu i ka cilësuar si të tillë melekët dhe pejgamberët e Tij:

﴿وَلَهُ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۚ وَمَنْ عِنْدَهُ لَا يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِهِ وَلَا يَسْتَحْسِرُونَ ۚ يُسَبِّحُونَ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ لَا يَفْتُرُونَ﴾

“Atij i përket gjithkush që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ata që janë tek Ai (melekët), nuk ngurrojnë për të adhuruar Atë e nuk ndiejnë lodhje, por e lavdërojnë (Atë) natën dhe ditën, paprerë.” [Enbija, 19-20]

Ndërsa në ajetin 206 të sures Arafë, i Lartësuari ka thënë:

﴿إِنَّ الَّذِينَ عِنْدَ رَبِّكَ لَا يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِهِ وَيُسَبِّحُونَهُ وَلَهُ يَسْجُدُونَ﴾

“Në të vërtetë, ata që janë afër Zotit tënd, nuk refuzojnë ta adhurojnë Atë, por e lavdërojnë dhe përulen në sexhde para Tij.”

Kurse ata që tregohen mendjemëdhenj i ka përçmuar:

﴿وَقَالَ رَبُّكُمُ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ ۚ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ﴾

“Zoti juaj ka thënë: “Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar.” [Gafir, 60]

Hyrje

Njerëzit më të zgjedhur të tij, Allahu i Lartësuar i ka cilësuar si robër adhures të Tij, siç ka thënë:

﴿عَيْنًا يَشْرَبُ بِهَا عِبَادُ اللَّهِ يُفَجِّرُونَهَا تَفْجِيرًا﴾

“... nga burimi që vetëm robërit e Allahut pinë dhe të cilin mund ta çojnë nga të duan.” [Insan, 6]

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا وَإِذَا خَاطَبَهُمُ الْجَاهِلُونَ قَالُوا سَلَامًا﴾

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!” [Furkan, 63]

E kur Shejtani tha:

﴿قَالَ رَبِّ بِمَا أَغْوَيْتَنِي لَأُزَيِّنَنَّ لَهُمْ فِي الْأَرْضِ وَلَأُغْوِيَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ ۖ إِلَّا عِبَادَكَ مِنْهُمُ الْمُخْلَصِينَ﴾

“Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t’ju zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t’i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të singertë.” [Hixhr, 39-40]

Allahu i Lartësuar iu përgjigj:

﴿إِنَّ عِبَادِي لَيْسَ لَكَ عَلَيْهِمْ سُلْطَانٌ إِلَّا مَنِ اتَّبَعَكَ مِنَ الْغَاوِينَ﴾

“Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robërit e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty.” [Hixhr, 42]

Pastaj, tekta i përshkruan melekët me këto cilësi, thotë:

﴿ وَقَالُوا اتَّخَذَ الرَّحْمَنُ وَلَدًا ۚ سُبْحَانَهُ بَلْ عِبَادٌ مُّكْرَمُونَ ﴿١﴾ لَا يَسْبِقُونَهُ بِالْقَوْلِ وَهُمْ بِأَمْرِهِ يَعْمَلُونَ ﴿٢﴾ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يَشْفَعُونَ إِلَّا لِمَنْ أَرَادَ أَنْ يَنْصِلَ ۚ وَهُمْ مِنْ خَشْيَتِهِ مُشْفِقُونَ ﴿٣﴾ ۝﴾

“Ata thonë: “I Gjithëmëshirshmi ka për Vete një bir (prej melekëve)”. Qoftë i lavdëruar Ai dhe i lartësuar! Jo, ata (melekët) janë robër të nderuar. Ata nuk flasin para (Fjalës së) Tij dhe veprojnë me Urdhrin e Tij. Ai e di se ç’ka para tyre (ç’kanë vepruar) dhe ç’ka pas tyre (çfarë do të veprojnë), ndërsa ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cilin Ai është i kënaqur, e prej frikës së Tij qëndrojnë me nderim dhe frikë (se mos i ndëshkon).” [Enbija, 26-28]

Po ashtu, Allahu ka thënë:

﴿ وَقَالُوا اتَّخَذَ الرَّحْمَنُ وَلَدًا ۚ لَقَدْ جِئْتُمْ شَيْئًا إِدًّا ﴿١﴾ تَكَادُ السَّمَاوَاتُ يَنْفَطَرْنَ مِنْهُ ۖ وَتَشَقُّ الْأَرْضُ ۖ وَتَخِرُّ الْجِبَالُ هَدًا ﴿٢﴾ أَنْ دَعَوْا لِلرَّحْمَنِ وَلَدًا ۚ وَمَا يَنْبَغِي لِلرَّحْمَنِ أَنْ يَتَّخِذَ وَلَدًا ۚ إِنْ كُلُّ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ إِلَّا آتِي الرَّحْمَنِ عَبْدًا ۚ لَقَدْ أَحْصَاهُمْ وَعَدَّهُمْ عَدًّا ۚ وَكُلُّهُمْ آتِيهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فَرْدًا ۚ ۝﴾

“Ata thonë: “I Gjithëmëshirshmi ka një bir”. Keni thënë diçka vërtet të tmerrshme! Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa s’çahet e malet sa s’rrëzohen të thërrmuar, ngaqë ata i veshin një bir të Gjithëmëshirshmit. Kurrë nuk i shkon (madhërisë së) të Gjithëmëshirshmit të ketë një bir. S’ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit. Sigurisht që Ai e njeh mirë gjithsecilin prej tyre dhe i ka numëruar të gjithë saktësisht. Çdonjëri prej tyre, në Ditën e Kiametit, do të dalë fill i vetëm para Tij.” [Merjem, 88-95]

Ndërsa për Isain (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!), për të cilin disa nga benu israilët pretendonin se ishte edhe Zot, edhe pejgamber, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنْ هُوَ إِلَّا عَبْدٌ أَنْعَمْنَا عَلَيْهِ وَجَعَلْنَاهُ مَثَلًا لِّبَنِي إِسْرَائِيلَ﴾

“Isai ishte vetëm një rob, të cilit Ne i dhuruam (Profeci) dhe e bëmë shembull për bijtë e Israilit.” [Zuhruf, 59]

Këtë na e vërteton edhe hadithi i saktë i Pejgamberit tonë ﷺ:

*“Mos më shenjtëroni siç e kanë shenjtëruar të krishterët të birin e Merjemes. Unë jam rob i Allahut, andaj thoni: "Rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij.”*⁵

Allahu i Lartësuar, edhe në ndodhinë më të shtrenjtë e më madhështore të nderimit të Pejgamberit ﷺ, në kohën e Israsë dhe Miraxhit, e cilësoi atë me emrin “rob”:

﴿سُبْحَانَ الَّذِي أَسْرَى بِعَبْدِهِ لَيْلًا مِّنَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ إِلَى الْمَسْجِدِ الْأَقْصَى﴾

“I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jerusalemit)...” [Isra, 1]

Të njëjtin term Allahu i Lartësuar e përdor edhe në suret Nexhm: 10, Xhin: 19 dhe në Bekare: 23.⁶

Pra, adhurimi përfshin fenë në tërësi.

Në një hadith tjetër të saktë transmetohet se si, një ditë, Xhibrili ﷺ i erdhi Pejgamberit ﷺ në pamjen e një beduini dhe e pyeti për Islamin, me ç’rast Pejgamberi ﷺ iu përgjigj:

⁵ Buhariu, 3445.

⁶ Dhe të gjitha aludojnë në atë se Muhamedi ﷺ ishte rob i Zotit.

“Islam është të dëshmosh se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të kryesh haxhin po pate mundësi.”

- Më trego për imanin (besimin), - tha ai.

“Iman është të besosh Allahun, melekët e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh në caktimin (kaderin), qoftë i mirë, qoftë i keq.”

- Më trego për ihsanin (përsosurinë në fetari)! - tha ai.

Pejgamberi ﷺ tha: *“Ta adhurosh Allahun sikurse je duke e parë. Edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.”*

Pastaj në fund të hadithit tha: *“Ai ishte Xhibrili, erdhi për t'jua mësuar fenë tuaj.”*⁷ Pra të gjitha këto që u përmendën më lart, Pejgamberi ﷺ i konsideroi fe (din).

Ndërsa vetë fjala “din” (gjuhësisht) ngërthen kuptimin e modestisë (thjeshtësisë) dhe të përlësisë. Ndërsa në raport me Allahun, dini është adhurimi i Tij, bindja ndaj Tij dhe përlja e plotë ndaj Tij.

Njëjtë, edhe ibadeti (adhurimi), në parim nënkupton nënshtrim. Madje, rrugës në gjuhën arabe i thuhet “muabed” (e shtruar), meqë është e shtruar mirë dhe e ngjeshur nga shkelja që ka pësuar.

⁷ Buhariu, 50.

Por, ibadeti me të cilin jemi urdhëruar ngërthen në vete kuptimin e nënshtrimit dhe të dashurisë, respektivisht, nënkupton piedestalin e nënshtrimit ndaj Allahut të Lartësuar bashkë me piedestalin e dashurisë ndaj Tij; ngase dashuria është shkallë-shkallë, fillon prej lidhjes së zemrës me atë që e do, pastaj pason varësia e zemrës nga dashuria, për të vazhduar me dashurinë e vazhdueshme, pastaj ashikëria (dashuria verbuese) dhe e fundit është robërimi (nënshtrimi) prej nga rrjedh edhe fjala “rob” i Allahut, gjegjësisht adhurues (abid) i Tij. Kështu për shembull kush i nënshtrohet urdhrit të një njeriu, ndaj të cilit ushqen urrejtje, ai nuk mund të konsiderohet abid i tij. Po ashtu, ai që dashuron diçka por nuk i nënshtrohet, nuk konsiderohet abid, sepse dikush mund ta dojë të birin apo shokun e tij, e këto dy cilësi nuk mjaftojnë për t'u quajtur adhurim. Pra s'ka adhurim të mirëfilltë pa dashuri, e as mund të ketë dashuri pa adhurim.

Nga kjo mund të konstatohet se nuk mjafton vetëm njëra nga këto dyja kur kemi të bëjmë me adhurimin ndaj Allahut të Lartësuar, por duhet që Allahu të jetë më i dashur për robin se çdo gjë tjetër, duhet të jetë më Madhështor se çdo gjë tjetër, madje askush tjetër nuk e meriton dashurinë dhe nënshtrimin e plotë pos Allahut të Madhërishëm. Për këtë arsye themi se çdo dashuri që i kushtohet tjetërkujt pos Allahut të Lartësuar, është dashuri e dështuar (e brishtë), e po ashtu çdo madhërim që i bëhet dikujt tjetër pos Allahut të Lartësuar është i kotë.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿قُلْ إِنْ كَانَ آبَاؤُكُمْ وَأَبْنَاؤُكُمْ وَإِخْوَانُكُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ وَعَشِيرَتُكُمْ وَأَمْوَالٌ
اقتَرَفْتُمُوهَا وَتِجَارَةٌ تَخْشَوْنَ كَسَادَهَا وَمَسَاكِينُ تَرْضَوْنَهَا أَحَبَّ إِلَيْكُمْ مِنَ اللَّهِ
وَرَسُولِهِ وَجِهَادٍ فِي سَبِيلِهِ فَتَرَبَّصُوا حَتَّى يَأْتِيَ اللَّهُ بِأَمْرِهِ ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ
الْفَاسِقِينَ﴾

“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.” [Tevbe, 24]

Së këndejmi, dashuria si lloj, po u lejuaka për Allahun, ashtu si edhe për Pejgamberin e Tij ,ﷺ gjë që vlen edhe për bindjen e plotë dhe të sinqertë ndaj dikujt (ta’a), e cila lejohet të jetë për Allahun e Lartësuar por edhe për Pejgamberin e Tij; për të vazhduar më tutje edhe me “razinë” (kënaqësinë) e cila mund të jetë përkitazi me Allahun, por edhe me Pejgamberin ﷺ (ngaqë Allahu ka thënë):

﴿وَاللَّهُ وَرَسُولُهُ أَحَقُّ أَنْ يُرْضُوهُ إِنْ كَانُوا مُؤْمِنِينَ﴾

“... por është më e drejtë të kënaqin Allahun dhe të Dërguarin e Tij.” [Tevbe, 62]

E njëjta vlen edhe për dhënien, ajo mund t’i atribuohet Allahut të Lartësuar, ashtu sikur edhe Pejgamberit të Tij (sikur në ajetin):

﴿وَلَوْ أَنَّهُمْ رَضُوا مَا آتَاهُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ﴾

“Sikur ata të kënaqeshin me atë që u ka dhënë Allahu dhe i Dërguari i Tij...” [Tevbe, 59]

Por, puna nuk qëndron kështu me ibadetin (adhurimin) dhe simotrat e tij: mbështetja në Allahun, frika ndaj Tij, e të ngjashme, sepse këto nuk lejohet t’i atribuohen askujt tjetër pos Allahut të Madhërishëm; siç thotë Allahu:

﴿قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِّنْ دُونِ اللَّهِ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُولُوا اشْهَدُوا بِأَنَّا مُسْلِمُونَ﴾

“Thuaj: “O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!” Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: “Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!” [Ali Imran, 64]

Pra, kur ishim te razia (kënaqësia), Allahu i Lartësuar tha:

﴿وَلَوْ أَنَّهُمْ رَضُوا مَا آتَاهُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَقَالُوا حَسْبُنَا اللَّهُ سَيُؤْتِينَا اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ وَرَسُولُهُ إِنَّا إِلَى اللَّهِ رَاغِبُونَ﴾

“Sikur ata të kënaqeshin me atë që u ka dhënë Allahu dhe i Dërguari i Tij, e të thoshin: “Na mjafton Allahu! Allahu do të na japë nga mirësitë e Veta; edhe i Dërguari i Tij. Ne vetëm tek Allahu i varim shpresat”...” [Tevbe, 59]

Dhënia (thamë se) i atribuohet Allahut, por edhe të Dërguarit të Tij, ﷺ sikur në ajetin:

﴿وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا﴾

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.” [Hashr, 7]

Por, kur jemi te mjaftueshmëria, vetëm Allahu na mjafton plotësisht, siç ka thënë i Lartësuar:

﴿الَّذِينَ قَالَ لَهُمُ النَّاسُ إِنَّ النَّاسَ قَدْ جَمَعُوا لَكُمْ فَاخْشَوْهُمْ فَزَادَهُمْ إِيمَانًا وَقَالُوا حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ﴾

“E atyre (shokëve të Pejgamberit) të cilëve dikush u tha: “Njerëzit (idhujtarë) janë tubuar t’ju sulmojnë, pra frikësojuni atyre! Kjo vetëm ua shtoi atyre besimin dhe thanë: “Neve na mjafton Allahu. Eh, sa mbrojtës i mrekullueshëm që është Ai.” [Ali Imran, 176]

E, po ashtu ka thënë:

﴿ يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ حَسْبُكَ اللَّهُ وَمَنِ اتَّبَعَكَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴾

“O Pejgamber! Allahu të mjafton ty dhe besimtarëve që të pasojnë.” [Enfalë, 64]

Dhe ka thënë:

﴿ أَلَيْسَ اللَّهُ بِكَافٍ عَبْدَهُ ﴾

“A nuk i mjafton Allahu robit të Vet?!” [Zumer, 36]

Pra, nga kjo kuptohet se të gjitha krijesat janë robër të Allahut, të mirë qofshin apo të këqij, besimtarë apo mohues (kufarë), xhenetlinjë apo xhehenemlinjë. Allahu i Lartësuar është Zoti dhe Sunduesi i të gjithëve, askush nuk mund t'i shmanget dëshirës dhe fuqisë së Tij absolute, e as mund të dalë përtej pushtetit të Emrave dhe Cilësive të Tij të përsosura, si dhe Fjalëve të Tij të shpallura (në Librat hyjnorë). Vetëm ajo që Ai dëshiron ndodh, edhe nëse ata nuk pajtohen me këtë dëshirë, dhe anasjelltas: nëse ata (robërit) dëshirojnë diçka e këtë nuk e dëshiron Allahu, kjo dëshirë nuk realizohet. Siç ka thënë i Lartësuari:

﴿ أَفَغَيْرَ دِينِ اللَّهِ يَبِغُونَ وَلَهُ أَسْلَمَ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ طَوْعًا وَكَرْهًا وَإِلَيْهِ يُرْجَعُونَ ﴾

“A mos kërkojnë ata diçka tjetër përveç fesë së Allahut, ndërkohë që Atij i përgjenden të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?!” [Ali Imranë, 83]

Kështu pra, Ai - qoftë i Lartësuar! - është Zot i gjithë botëve, Krijuesi dhe Furnizuesi i tyre, Ai jep jetë dhe vdekje, Ai i rrotullon dhe i ndryshon zemrat e robërve të Tij dhe kujdeset për çështjet e tyre. Krijesat nuk kanë Zot tjetër pos Tij, e as kanë Sundues apo

Hyrje

Krijues tjetër pos Tij, e pranuan këtë apo e refuzuan, e ditën apo nuk e ditën. Por, e vërteta është se besimtarët e vërtetë e dinë këtë dhe pranojnë (pa rezerva), për dallim prej injorantëve, apo atyre që me qëllim kundërshtojnë dhe bëhen mendjemëdhenj ndaj Zotit të tyre, as e pranojnë Fjalën e Tij e as i nënshtrohen Atij, ndonëse e kanë të qartë se Allahu është Zoti dhe Krijuesi i tyre.

Kësisoj, njohja e së vërtetës absolute, kur shoqërohet me mendjemadhësi ndaj pranimi të saj dhe kundërshtim të hapët, do të shndërrohet në dënim për bartësin e saj, siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿ وَجَدُوا بِهَا وَاسْتَيْقَنَتْهَا أَنْفُسُهُمْ ظُلْمًا وَعُلُوًّا فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُفْسِدِينَ ﴾

“Kështu, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërteta. Pa shiko, cili ka qenë fundi i shkatërrimtarëve!” [Neml, 14]

I Lartësuari ka thënë:

﴿ الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَعْرِفُونَهُ كَمَا يَعْرِفُونَ أَبْنَاءَهُمْ وَإِنَّ فَرِيقًا مِّنْهُمْ لَيَكْتُمُونَ الْحَقَّ وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴾

“Ata që u kemi dhënë Librin, e njohin atë (Muhamedin, ﷺ) ashtu siç i njohin bijtë e tyre, por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, duke e ditur mirë.” [Bekare, 146]

Po ashtu ka thënë:

﴿ فَإِنَّهُمْ لَا يُكَذِّبُونَكَ وَلَكِنَّ الظَّالِمِينَ بِآيَاتِ اللَّهِ يَجْحَدُونَ ﴾

“Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e Allahut.” [En’am, 33]

Kur robi pranon se Allahu është Krijuesi dhe Kujdestari i tij i vetëm, si dhe se, para Madhërisë së tij, është i varfër e ka nevojë për

Të, vetëm atëherë e ka njohur adhurimin që ka të bëjë me “rububijen” - pushtetin e plotë të Allahut ndaj robit të Vet.

Në anën tjetër, nëse robi e lut Zotin e tij, i përgjërohet me nënshtrim, mbështetet tek Ai, por pastaj, herë i bindet urdhrat të Tij e herë rebelohet, vazhdon që herë t’ia kushtojë adhurimin Allahut, e herë t’ia kushtojë shejtanit e idhujve. Një adhurim i tillë nuk i dallon dot banorët e Xhenetit nga banorët e Zjarrit, e as mund të bëhet besimtar personi që vepron kësisoj. Siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿ وَمَا يُؤْمِنُ أَكْثَرُهُم بِاللَّهِ إِلَّا وَهُمْ مُشْرِكُونَ ﴾

“Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun, pa i shoqëruar Atij njëkohësisht (idhuj të rremë) në adhurim.” [Jusuf, 106]

Edhe paganët (mushrikët) e Mekës gjithnjë kanë pranuar se Zoti është Krijuesi dhe Furnizuesi i tyre, por përkundër kësaj, e kanë adhuruar tjetërkënd. Pikërisht këtë e vërteton edhe ajeti:

﴿ وَلَئِنْ سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ ﴾

"Po nëse i pyet ata se kush i krijoi qiejt e tokën, sigurisht ata do të thonë: Allahu!..." [Zumer, 38]

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ قُلْ لِمَنِ الْأَرْضُ وَمَنْ فِيهَا إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ۖ سَيَقُولُونَ لِلَّهِ ۚ قُلْ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ۚ قُلْ مَنْ رَبُّ السَّمَاوَاتِ السَّبْعِ وَرَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ۚ سَيَقُولُونَ لِلَّهِ ۚ قُلْ أَفَلَا تَتَّقُونَ ۚ قُلْ مَنْ بِيَدِهِ مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ وَهُوَ يُجِيرُ وَلَا يُجَارُ عَلَيْهِ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ۚ سَيَقُولُونَ لِلَّهِ ۚ قُلْ فَأَنَّى تُسْحَرُونَ ﴾

“Thuaj: “E kujt është Toka dhe gjithçka që gjendet në të, nëse e dini?” Ata do të thonë: “Të Allahut!” E ti thuaju: “Vallë, a nuk po ia vini veshin?” Thuaj: “Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Fronit Madhështor?” Ata do të thonë:

“Allahu!” E ti thua ju: “Vallë, a nuk keni frikë ju?” Thuaj: “Kush është Ai që ka në dorë pushtetin mbi çdo gjë, i Cili mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush, nëse e dini?” Ata thonë: “Allahu.” E ti thua ju: “Atëherë, përse magjepseni?” [Mu’minunë, 84-89]

Shumë prej atyre që flasin për këtë realitet⁸, dëshmojnë vetë për këtë të vërtetë absolute, sepse ajo është e vërteta kosmologjike në të cilën merr pjesë secili me dëshminë e vet, dhe njohjen e saj e dëshmon si besimtar, ashtu edhe jobesimtar, si i miri ashtu edhe i keqi, bile këtë e dëshmojnë edhe Iblisi (djalli) me banorët e Zjarrit. Saqë Iblisi thotë:

﴿ قَالَ رَبِّ فَأَنْظِرْنِي إِلَى يَوْمِ يُبْعَثُونَ ﴾

“O Zoti im, më jep afat deri në ditën kur do të ringjallen!”⁹ [Sad, 79]

Allahu i Lartësuar në një ajet tjetër ka thënë:

﴿ قَالَ رَبِّ بِمَا أَغْوَيْتَنِي لَأُزَيِّنَنَّ لَهُمْ فِي الْأَرْضِ وَلَأُغْوِيَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ ﴾

“Iblisi tha: “Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t’ju zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t’i shpie në mashtrim.” [Hixhr, 39]

Iblisi po ashtu tha:

﴿ قَالَ أَرَأَيْتَكَ هَذَا الَّذِي كَرَّمْتُ عَلَيَّ لَئِنْ أَخَّرْتَنِي إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ لَأَحْتَنِنَنَّ ذُرِّيَّتَهُ إِلَّا قَلِيلًا ﴾

⁸ Domethënë: Realitetin e rububijes dhe ekzistencës së Allahut, siç janë sufitet dhe të ngjashmit.

⁹ Ky ajet vërteton se edhe Iblisi ka besuar në Ditën e ringjalljes.

“A e sheh këtë që Ti e nderove mbi mua? Nëse Ti më jep kohë deri në Ditën e Kiametit, unë do t’i shfaros me mashtrim pasardhësit e tij, përveç një pakice prej tyre!” [Isra, 62]

Në të gjitha këto ajete që i veçuam, Iblisi pranon se Allahu është Zoti dhe Krijuesi i tij dhe i të tjerëve. Po ashtu, këtë e pohojnë edhe banorët e Zjarrit:

﴿ قَالُوا رَبَّنَا غَلَبَتْ عَلَيْنَا شِقْوَتُنَا وَكُنَّا قَوْمًا ضَالِّينَ ﴾

"Ata thonë: O Zoti ynë, ne patën mundur të këqijat dhe si të tillë, ishim popull i humbur!" [Mu'minunë, 106]

Për të këtillët, Allahu i Lartësuar tha:

﴿ وَلَوْ تَرَىٰ إِذْ يُفْقَرُ عَلَىٰ رَبِّهِمْ ۖ قَالَ أَلَيْسَ هَٰذَا بِالْحَقِّ ۖ قَالُوا بَلَىٰ وَرَبَّنَا ۖ قَالَ فَذُوقُوا الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ تَكْفُرُونَ ﴾

“Ah, sikur t’i shohësh ata kur të dalin para Zotit! Ai do t’ju thotë: “A nuk është e vërtetë kjo?” Ata do të përgjigjen: “Po, është e vërtetë, për Zotin tonë!” Allahu do t’u thotë: “E pra, tani shijoni dënimin, sepse nuk besuat!” [En’am, 30]

Pra, kush ndalet vetëm te kjo e vërtetë dhe vetëm te dëshmia e saj, ndërkaq nuk e kryen urdhrin e Zotit sipas parimeve të dinit islam lidhur me adhurimin ndaj Allahut të Lartësuar (uluhije), respektivisht nuk e realizon çdo urdhër të Allahut të Lartësuar dhe të të Dërguarit të Tij, ai njeri i përket familjes së Iblisit dhe banorëve të Zjarrit. E nëse, përkundër kësaj, ai mendon se është prej burrave të dalluar e të dashur tek Allahu (evlijave), si dhe prej atyre që janë të pajisur me diapazon të gjerë të dijes e njohurive - madje mendon se nuk është i obliguar fare të urdhërojë për të mirë dhe të ndalojë nga e keqja - atëherë i këtilli është prej njerëzve më të mbrapshtë mohues e jobesimtarë.

Po ashtu, kush mendon se Hidri (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!)¹⁰ dhe të tjerët si ai, janë të liruar nga urdhrat hyjnorë, për shkak të dëshmisë dhe largpamësisë së tyre për qëllimet dhe vendimet e Zotit, një mendim i këtillë bën pjesë në fjalët më të shëmtuara të mohuesve të Allahut dhe të Dërguarit të Tij .ﷺ I këtilli nuk do të shpëtojë prej këtij epiteti derisa të bëhet Abid (adhurues i nënshtruar), i cili e adhuron vetëm Allahun e Lartësuar dhe i kryen vetëm urdhrat e Tij e të Pejgamberit të Tij ,ﷺ i do vetëm njerëzit e mirë, besimtarë e të devotshëm, ndërsa u kundërvihet armiqve të Allahut të Lartësuar.

Ky lloj adhurimi është i lidhur drejtpërdrejt me meritën absolute të Allahut për t'u adhuruar (ilahijetin), dhe kjo ka bërë që adresa e tevhidit (njësimi të Allahut) të jenë në fjalët: “La ilahe ilallah” (s’ka të adhuruar të denjë përveç Allahut), e jo të besohet formalisht: të pranohet Zoti si krijues e si furnizues e të mos adhurohet, ose të adhurohet bashkë me të edhe dikush tjetër (t’i bëhet shok Zotit). Pra i adhuruar (ilah) quhet vetëm ai të cilin zemra e hyjnizon, plot dashuri e plot madhëri, plot respekt e nder, plot frikë e shpresë, e të ngjashme, dhe vetëm ky është adhurimi të cilin Allahu i Lartësuar e do dhe me të cilin është i Kënaqur. Me këto veti Zoti i cilësoi të zgjedhurit nga robërit e Tij dhe për këtë lloj ibadeti i dërgoi të dërguarit e Tij.

E, sa i përket robit në kuptimin e të qenët i robëruar - pranoi të jetë i këtillë apo refuzoi - në këtë kuptim janë të barabartë si besimtari ashtu edhe jobesimtari. Zaten, përmes dallimit të këtyre dy llojeve, kuptohet dallimi midis koncepteve fetare, të cilat bëjnë pjesë në adhurimin e Allahut, në dinin e Tij dhe në urdhrin e Tij sheriatik, gjërat të cilat Allahu i do, dhe me të cilat është i Kënaqur, bartësit e

¹⁰ Autori merr për shembull Hidrin për shkak të përrallave dhe trillimeve të sufive dhe grupeve të devijuara, si dhe besimeve të tyre të kota që kishin shpikur në lidhje me të.

të cilave i afron afër Vetes dhe i nderon me Xhenetin e Tij; dhe midis koncepteve kosmologjike në anën tjetër, në të cilat janë të barabartë si besimtari ashtu edhe jobesimtari, i miri dhe i keqi, e të cilat, kushdo që i konsideron të mjaftueshme, dhe për pasojë nuk ndjek konceptet fetare, bëhet pasues i Iblisit të mallkuar dhe i atyre që e mohojnë Zotin e gjithësisë; ndërsa, nëse dikush mjaftohet me këto koncepte në disa çështje, por jo në të gjitha, ose në disa rrethana, por jo në të gjitha, ose në disa gjendje, por jo në të gjitha, në atë rast, besimi dhe afërsia e tij me Allahun zvogëlohen në proporcion me mangësitë që ka në raport me konceptet fetare.

Një besim i këtillë është mejdan i gabimit të shumë njerëzve, ku është shtuar mjegullia në mesin e ndjekësve të kësaj rruge, madje këtu kanë rrëshqitur edhe dijetarë të mëdhenj të cilët thirrreshin për njerëz të praktikës, tevhidit dhe njohjes së fesë, numrin e të cilëve e di vetëm Allahu, Njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes. Këtë kishte për qëllim shejh Abdulkadër Xhejlani - Allahu e mëshiroftë! - sipas asaj që është transmetuar nga ai se ka thënë: "Shumë njerëz, me të arritur tek temat që kanë të bëjnë me kadanë dhe kaderin¹¹, janë ndalur aty¹², përveç meje; ngase, ç'është e vërteta, mua më është hapur një dritare në këtë lëmi, andaj veprova në kundërshtim me caktimet (kaderin) me qëllim të arritjes deri te e vërteta (haku), sepse burrë është ai i cili vepron për ta larguar kaderin, e jo ai që pajtohet me kaderin." (mbaroi fjala e tij).¹³

¹¹ Caktimi i Allahut, i cili përfshin çdo vepër të njeriut dhe çdo gjë që ndodh në gjithësi.

¹² Dhe ky është veprimi i kërkuar, ngase Pejgamberi ka thënë: "*Kur përmendet kaderi (caktimi i Allahut), ndaloni aty (mos hulumtoni)!*"

¹³ Autori ka një shpjegim të gjerë në lidhje me këtë fjalë të Abdulkadir Xhejlanit në "Mexhmu el-Fetava" (8/547); me pak fjalë: kërkohet që njeriu ta kundërshtojë grynahun me pendim, bidatin me sunet, mëkatën me vepra të mira, e kështu me radhë.

Hyrje

Ajo që e ka përmendur shejhu (Allahu e mëshiroftël), në fakt, është ajo me të cilën ka urdhëruar Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij ﷺ.

Megjithatë, shumica e njerëzve kanë gabuar në këtë aspekt, ngase ata duke qenë dëshmitarë të mëkateve dhe gjynaheve të ndryshme që u janë caktuar t'i veprojnë, ose duke parë njerëzit e tjerë duke i vepruar këto gjëra, madje edhe kufrin (mosbesimin) e qartë, rrjedhimisht, duke qenë dëshmitarë se të gjitha këto ndodhin me dëshirën (lejen) e Allahut, me kadanë dhe kaderin e Tij, dhe ngjajnë brenda ligjit të Tij kosmologjik dhe në ujdi me dëshirën e Tij, mendojnë se duhet thjesht t'u nënshtrohen të lartcekurave, të pajtohen me to dhe të jenë të kënaqur, e kështu këtë e marrin si din, rrugë të cilën duhet ndjekur dhe adhurim, duke kopjuar kështu idhujtarët të cilët thoshin:

﴿لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا أَشْرَكْنَا وَلَا آبَاؤُنَا وَلَا حَرَمْنَا مِنْ شَيْءٍ﴾

“Sikur të donte Allahu, nuk do të adhuronim tjetër veç Tij as ne, as baballarët tanë dhe ne nuk do të kishim bërë të ndaluar asgjë.” [Enam, 148]

Po ashtu thoshin:

﴿أَنْطَعِمُ مَنْ لَوْ يَشَاءُ اللَّهُ أَطْعَمَهُ﴾

“Pse, ne do t'i ushqejmë ata që, po të donte Allahu, do t'i ushqente Vetë?” [Jasin, 46]

Dhe thanë:

﴿وَقَالُوا لَوْ شَاءَ الرَّحْمَنُ مَا عَبَدْنَاهُمْ﴾

“Sikur të kishte dashur i Gjithëmëshirshmi, ne nuk do t'i kishim adhuruar ata.” [Zuhruf, 20]

E sikur të ishin të udhëzuar siç duhet, do ta kuptonin se ne jemi urdhëruar të jemi të kënaqur me kaderin, rrjedhimisht të pajtohemi me gjërat që ndërliken me të, siç janë fatkeqësitë që na godasin, si varfëria, sëmundja dhe frika.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿ مَا أَصَابَ مِنْ مُصِيبَةٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ وَمَنْ يُؤْمِنْ بِاللَّهِ يَهْدِ اللَّهُ قَلْبَهُ ۚ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ۝ ﴾

“Çdo fatkeqësi që i bie njeriut, ndodh me vullnetin e Allahut. Ai ia udhëzon zemrën kujt do që i beson Atij. Allahu di mirë çdo gjë.” [Tegabun, 11]

Disa nga të parët e umetit (selefët) në lidhje me këtë ajet kanë thënë: “Është për qëllim njeriu të cilin e godet një fatkeqësi, e di që është prej Allahut, andaj është i kënaqur dhe nënshtrohet.”

I Lartësuari ka thënë:

﴿ مَا أَصَابَ مِنْ مُصِيبَةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي أَنْفُسِكُمْ إِلَّا فِي كِتَابٍ مِّن قَبْلِ أَنْ نَبْرَأَهَا ۚ إِنَّ ذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ۝ لَّكَيْلًا تُأْسُوا عَلَىٰ مَا فَاتَكُمْ وَلَا تَفْرَحُوا بِمَا آتَاكُمْ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ ۝ ﴾

“S’ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhi Mahfûdh) më parë se ta krijojmë atë. Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! (Këtë paracaktim e kemi bërë) që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë. Allahu nuk i do kryelartët mburravecë.” [Hadid, 22-23]

Ndërkaq, në dy librat e saktë të hadithit (sahihajn)¹⁴, përcillet nga Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Ademi dhe Musai debatuan mes vete dhe Musai*

¹⁴ Buhariu, 3409; Muslimi, 2652; nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Hyrje

i tha: "Ti je Ademi, që të nxori mëkati yt prej Xhenetit!" Ademi ia ktheu: "Ndërsa, ti je Musai, që Allahu të përçjodhi me shpallje dhe të foli drejtpërdrejt, e pastaj po më fajëson mua për diçka që më është përcaktuar para se të krijohem." I Dërguari i Allahut ﷺ tha: "Ademi triumfoi kundrejt Musait."

Triumfi i Ademit ﷺ në debatin e tij me Musain ,ﷺ nuk kishte të bënte me atë se ai mendonte se mëkatari bën të arsyetohet me kader (për ta vepruar mëkatin); një fjalë të tillë nuk e thotë muslimani, e as ai që ka mendje të shëndoshë. Sikur kjo të llogaritej arsye, atëherë do t'i llogaritej Iblisit, popullit të Nuhit ,ﷺ popullit të Hudit ,ﷺ e çdo jobesimtari tjetër.

Zaten, as vetë Musai ﷺ nuk e qortoi Ademin ﷺ në lidhje me mëkatin, ngase Ademi tashmë ishte penduar tek Zoti i tij, e Ai ia ka pranuar pendimin dhe e ka udhëzuar, por e qortoi për fatkeqësinë me të cilën u godit pas veprimit të atij mëkati, për këtë arsye i tha: "Përse na nxore ne dhe vetveten nga Xheneti?" Me ç'rast Ademi ia ktheu: "Kjo ka qenë e shkruar për mua para se të krijohem."

Rrjedhimisht, edhe vepra, edhe fatkeqësia që e pasoi atë, ishin të caktuara, andaj për fatkeqësitë që janë përcaktuar të ndodhin, e kemi obligim t'u nënshtrohemi, sepse kjo është kënaqësia e plotë me Allahun Zot.

E, sa u përket mëkateve, rob i nuk bën të mëkatojë, e nëse mëkaton, obligohet të kërkojë falje dhe të pendohet, respektivisht, të pendohet prej gjynaheve e të durojë ndaj fatkeqësive.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿فَاصْبِرْ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ وَاسْتَغْفِرْ لِذَنْبِكَ﴾

“Andaj, bëhu i durueshëm ti (o Muhamed!), sepse, pa dyshim, premtimi i Allahut është i vërtetë. Lutju Zotit për faljen e gjynaheve të tua...” [Gafir, 55]

Po ashtu ka thënë:

﴿وَإِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا لَا يَضْرُكْكُمْ كَيْدُهُمْ شَيْئًا﴾

“Nëse ju duroni dhe ruheni nga gjynahet, dinakëritë e tyre nuk mund t’ju dëmtojnë aspak.” [Ali Imran, 120]

Dhe ka thënë:

﴿وَإِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ﴾

“Por, nëse ju duroni dhe ruheni (nga të këqijat), atëherë kjo është vërtet gjëja vendimtare.” [Ali Imran, 186]

Jusufi ﷺ ka thënë:

﴿إِنَّهُ مَنْ يَتَّقِ وَيَصْبِرْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ﴾

“Atë që ruhet (nga gjynahet) dhe bëhet i durueshëm, Allahu e shpërblen, se Ai kurrë nuk ia humb shpërblimin punëmireve” [Jusuf, 90]

Bazat mbi të cilat ngrihet adhurimi

Adhurimi ndërtohet mbi dy baza: të mos adhurohet kush tjetër pos Zotit të Lartësuar dhe të mos adhurohet ndryshe pos me ato vepra me të cilat Ai na ka urdhëruar. Kjo mund të kuptohet nga Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَهُكُمُ إِلَهُ وَاحِدٌ ۖ فَمَن كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا ۝﴾

“Thuaj: “Unë jam vetëm një vdekatar si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm. Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!” [Kehf, 110]

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿بَلَىٰ ۖ مَن أَسْلَمَ وَجْهَهُ لِلَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ فَلَهُ أَجْرُهُ عِندَ رَبِّهِ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ۝﴾

“Vërtet, ata që i përgjigjen Allahut dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.” [Bekare, 112]

Kurse në ajetin 125 të sures Nisa thotë:

﴿وَمَن أَحْسَنُ دِينًا مِّمَّنْ أَسْلَمَ وَجْهَهُ لِلَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ وَاتَّبَعَ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا ۖ وَاتَّخَذَ اللَّهُ إِبْرَاهِيمَ خَلِيلًا ۝﴾

“Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet singërisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, të cilin Allahu e ka marrë për mik të ngushtë?”

Prandaj vepra e mirë është bamirësi, gjegjësisht punë e mirë (hasenat). Pra, hasenat janë ato punë dhe sjellje të mira të cilat i do

Allahu dhe i Dërguari i Tij ,ﷺ për kryerjen e të cilave njerëzit janë urdhëruar nga ana e Allahut të Lartësuar me në mënyrë obligative apo në mënyrë vullnetare.

E, sa u përket shpikjeve (bidateve) në fe, të cilat nuk gjenden në Kuran dhe në hadithet e sakta, - i tha kush i tha, i vepro i kush i vepro i -, ato nuk i përkasin sheriatit, Allahu dhe i dërguari i Tij nuk i duan këto punë, dhe si të tilla, nuk quhen vepra të mira e as bamirësi. Pra dikush që punon një vepër që nuk lejohet – punë të ndyra dhe padrejtësi - një gjë e tillë s'mund të jetë hasenat e as bamirësi.

Kurse Fjala e Allahut që u theksua më sipër: **"... dhe të mos i shoqërojnë askënd në adhurim Zotit të vet!"**, si dhe ajeti tjetër pas tij: **"...ai që i dorëzohet singerisht Allahut"**, kanë për qëllim se besimi (dini) ndaj Zotit duhet të jetë i singertë vetëm për Allahun e Lartësuar. Për këtë arsye Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i bënte lutje Zotit kështu: "O Allah, bëmi të gjitha veprat e mia të mira, bëmi ato të singerta vetëm për Fytyrën Tënde, dhe mos lejo që të përmbajnë diçka për dikë tjetër pos Teje!" Kurse Fudajl ibni Ijadi, rreth fjalës së Allahut në suren Mulk, ajeti i dytë:

﴿ الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا ۚ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْعَفُورُ ۝ ﴾

"Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë..."

Tha: "Me këto fjalë Allahu ka për qëllim veprat më të singerta dhe më të sakta." Shokët e tij e pyetën: "O Ebu Ali! Cilat janë më të singertat dhe më të saktat, vallë?!" Ai u përgjigj: "Nëse vepra është e singertë por nuk është e saktë, nuk pranohet, sikur që nëse vepra është e saktë por nuk është e singertë, nuk pranohet." Pra, vepër e singertë është ajo që bëhet për Allahun. Kurse vepër e saktë është ajo që bëhet sipas sunetit.

Dallimet sipas imanit (besimit)

Për këtë shkak njerëzit ndahen në dy grupe: Grupi i parë janë ata të cilët gjenden në rrugë të gabuar, të cilët e besojnë Allahun e Lartësuar për Krijues dhe Kujdestar të tyre, por nuk i kryejnë urdhrat e Tij; dhe grupi tjetër janë ata që i shoqërojnë Zotit dikë tjetër në adhurim, bëjnë shirk, e ky shirk mund të jetë aq i padukshëm dhe i fshehur sa gjurmët e buburrecit.

Pikërisht për këtë, është përcjellë në hadith të saktë se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Është shkatërruar rob i dinarit dhe i dërhemit, e rob i shtrojave dhe petkave. Nëse i jepet diçka, shprehet i kënaqur, e nëse nuk i jepet, hidhërohet.”*¹⁵ Pra, Pejgamberi ﷺ njeriun e këtillë e quajti rob i dërhemit, respektivisht rob të dinarit e të petkave. Gjë që nënkupton se atë që e godet sherri i këtillë, s'mund të shpëtojë dot nga sherri, e as të arrijë ndonjë qëllim të caktuar, sepse ky është fati i robërve të pasurisë, mu ashtu siç i përshkroi Pejgamberi ﷺ se nëse i jepet diçka, shprehet i kënaqur (razi), e nëse nuk i jepet, hidhërohet.

Këtë e gjejmë edhe në Fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿ وَمِنْهُمْ مَّنْ يَلْمِزُكَ فِي الصَّدَقَاتِ فَإِنْ أُعْطُوا مِنْهَا رَضُوا وَإِنْ لَمْ يُعْطُوا مِنْهَا إِذَا هُمْ يَسْخَطُونَ ﴾

“Ka edhe të tillë që të qortojnë për shkak të ndarjes së lëmoshës. Nëse atyre u jepet ndonjë pjesë, ata kënaqen, por, nëse nuk u jepet, përnjëherë zemërohen.” [Tevbe, 58]

E këtillë është gjendja e atyre që janë të lidhur me pozita udhëheqësie apo me ashikëri, e gjëra të ngjashme që ndërldihen me epshet e njerëzve, saqë, nëse e arrin atë, kënaqet, e nëse nuk e arrin, hidhërohet. Ky pra është rob i epshit të vet, në vend që të jetë rob i Allahut të Lartësuar - sepse, në fakt, robërimi është adhurimi -. Për

¹⁵ Buhariu, 6435.

këtë, një fjalë e urtë arabe thotë: “Robi është i lirë kur pajtohet dhe kënaqet (me Allahun), kurse i liri është rob kur bën pasuri të bollshme.” Ndërsa një shkrimtar tjetër i njohur thotë: “E zgjata tamahin (lakminë për pasuri) e më robëroi, e, po të isha i kënaqur me pak, do të isha i lirë”.

Kurse, në lidhje me lakminë e madhe për pasuri (tamah), arabët thonë se është sikur prangat që çelësin e kanë në fyt e zinxhirët në këmbët e njeriut, andaj, vetëm kur hiqet çelësi nga fyti, lirohen edhe këmbët nga prangat.¹⁶

Transmetohet nga Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ka thënë: “Tamahi (lakmia) është varfëri, sikur që e kundërta e kësaj: këputja e shpresës, është pasuri e madhe për njeriun, sepse një gjë që për të cilën nuk ke shpresë për ta arritur, nuk të nevojitet.”

Këtë mund ta provojë çdonjëri në vetvete, diçka për të cilën nuk i jep vetes shpresë se do ta arrish, s'ke nevojë ta kërkosësh dhe zemra nuk është e varfër as për të, e as për atë që do t'ia sillte. Sikundërqë, nëse lakmon dhe shpreson që ta arrijë një gjë të caktuar, atëherë zemra do t'i lidhet për atë gjë, do të ndjehet i varfër për të arritur deri tek ajo dhe deri tek personi i cili do të bëhet shkaktar për t'ia sjellë atë gjë. Kjo është e aplikueshme si në lakmi për pasuri, ashtu për prestigj, ashikëri, e gjëra të ngjashme.

Kurse Allahu i Lartësuar, duke përmendur fjalën e Ibrahimit , ﷺ thotë:

{ فَابْتَغُوا عِنْدَ اللَّهِ الرِّزْقَ وَاعْبُدُوهُ وَاشْكُرُوا لَهُ ۚ إِلَيْهِ تُرْجَعُونَ }

“Vetëm tek Allahu kërkon risk dhe adhuron i falënderoni vetëm Atë. Tek Ai do të ktheheni.” [Ankebutë, 17]

¹⁶ Tek ne (shqiptarët) përdoret thënia: "Ra fyti e të mbyti".

Pra, robi e merr rrizkun sepse ka nevojë për të, e kur këtë e lyp nga Allahu i Lartësuar, i robërohet vetëm Atij, bëhet i varfër vetëm para Tij, por, nëse në anën tjetër këtë e kërkon prej tjetërkujt, atëherë vetvetiu kuptohet se i bëhet rob tjetërkujt - nevojtar për të.

Për këtë arsye, në parim, lypja nga njerëzit është e ndaluar, por lejohet vetëm në raste domosdoshmërie. Kjo ndalesë ka mbështetje në shumë hadithe të vërteta, ndër to fjala e Pejgamberit :ﷺ *‘Njeriu vazhdon t’u lypë të tjerëve, derisa Ditën e Kiametit vete pa i mbetur asnjë copë mishi në fytyrë.’*¹⁷ Kurse hadithi tjetër thotë: *”Kush lyp, edhe pse ka pasuri të bollshme, lypja e tij në Ditën e Kiametit do të vijë dhe do t’ia gërvishhtë (copëton) fytyrën.”* Apo hadithi tjetër ku thuhet: *”Nuk lejohet lypja pos në raste të jashtëzakonshme siç është borxhi i rëndë, pagesa e gjakut apo rasti i skamjes (varfërisë) së madhe.”* Ose hadithi tjetër ku thuhet: *”Për atë që merr litarin e vet, bart barrën e druve në shpinë dhe i shet, në mënyrë që Allahu t’ia ruajë fytyrën, është më mirë sesa t’u lypë njerëzve, pavarësisht a i japin a s’i japin.”* Kurse në një hadith tjetër të Pejgamberit :ﷺ thuhet: *“Atë që kërkon ndershmëri, Allahu e bën të ndershëm. Atë që mjaftohet me pasurinë që ka, Allahu e bën të pasur. Dhe atë që tregon durim, Allahu e bën të durueshëm. Askujt nuk i është dhënë ndonjë dhunti më e mirë e më e madhe sesa durimi.”*

Pejgamberi :ﷺ i këshillonte shokët e vet më të ngushtë që të mos kërkojnë gjë nga njerëzit. Ndërsa në "Musned" transmetohet se Ebu Bekrit i kishte rënë njëherë shkopi nga dora dhe nuk i kishte thënë askujt: *“ma jep!”*, por kishte thënë: *“Miku im (Pejgamberi :ﷺ) më ka këshilluar që të mos kërkoj gjë nga dikush”*. Ndërsa në sahihun e Muslimit transmetohet nga Auf ibn Maliku se Pejgamberi :ﷺ kur mori besatimin nga një grup sahabësh, i porositi me një fjalë të fshehtë (në besë) duke iu thënë: *“Nga njerëzit mos kërkonit asgjë!”*. Prandaj shumica e tyre, ndër ta edhe Ebu Bekri, edhe nëse iu binte shkopi në tokë, nuk kërkonin prej askujt t’ia japë.

¹⁷ Buhariu, 1474.

Të gjitha këto që u thanë gjer më tani argumentojnë qartë porosinë se është e ndaluar të kërkohet prej dikujt tjetër pos prej Allahut të Lartësuar.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ ۖ وَإِلَىٰ رَبِّكَ فَارْغَبْ﴾

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpigu fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!”
[Sherh, 7-8]

Kurse në një rast, Pejgamberi ﷺ i kishte thënë Ibn Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me të!): *“Kur të lypësh, lypi Allahut e, kur të kërkosh ndihmë, kërko nga Allahu!”*

Këtë e sinjalizon edhe Allahu i Lartësuar në suren Ankebutë:

﴿فَابْتَغُوا عِنْدَ اللَّهِ الرِّزْقَ ...﴾

“Vetëm tek Allahu kërkon risk...” [Ankebutë, 17]

Vini re, në ajetin e mësipërm nuk ka thënë: “Kërkojeni riskun tek Allahu!”, por ia ka paraprirë me “tek Allahu”, pastaj ka thënë “kërkon risk”, për shkak se në gjuhën arabe, çdo paraprirje e shprehjeve në fjali nënkupton veçim dhe përkufizim, gjë që, në rastin në fjalë është sikur të thuhet: “Askund tjetër mos e kërkon riskun, përveç tek Allahu i Lartësuar.” Allahu i Lartësuar po ashtu ka thënë:

﴿وَأَسْأَلُوا اللَّهَ مِنْ فَضْلِهِ﴾

“Kërkon prej Allahut nga mirësitë e Tij.” [Nisa, 32]

Pra, njeriu patjetër duhet të arrijë deri tek pasuria (risku) për të cilën ka nevojë, e njëkohësisht të përpigjet ta largojë nga vetja atë që është e dëmshme. Në të dyja rastet, njeriut i preferohet që t'i lutet

vetëm Allahut të Lartësuar, dhe mos t'i kërkojë risk askujt tjetër pos Allahut, si dhe mos t'i ankohet askujt tjetër përveç Atij. Zaten, kështu na mëson edhe Kurani, përmes gjuhës së Jakubit ﷺ:

﴿ قَالَ إِنَّمَا أَشْكُو بَثِّي وَحُزْنِي إِلَى اللَّهِ ﴾

“Unë dhimbjen time dhe pikëllimin tim ia paraqes vetëm Allahut.” [Jusuf, 86]

Allahu i Lartësuar ka përmendur në Kuran shprehje si në vijim¹⁸: ”El hexhrul xhemil” - shmangie e bukur; ”Es safhul xhemil” - ndjesë e bukur; dhe ”Es sabrun xhemil” - durim i bukur. Pra nëse dikush të ofendon apo të sulmon duhet t'i përdorësh këto tri metoda:

1. Shmangie e bukur: T'i shmangesh sulmuesit, pa e dëmtuar,
2. Ndjesë e bukur: T'i largohesh atij pa e qortuar fare, dhe
3. Durim i bukur: Ta durosh pa iu ankuar askujt.

Për këtë arsye, kur Ahmed ibn Hanbelit, gjatë kohës kur ishte në sëmundjen e vdekjes, dikush i tregoi se Tavusi¹⁹ e urrente që i sëmuri të rënkonte, sepse kjo gjë llogaritet ankesë, atëherë imam Ahmedi ndaloi së rënkuari, derisa i erdhi vdekja.

Ndërsa sa i përket ankesës drejtuar Krijuesit, një gjë e tillë lejohet dhe nuk bie ndesh me durimin e bukur (sabrun xhemil), të cilin e ka përmendur Jakubi ,ﷺ i cili tha: **“(Do të bëj) Durim të bukur (sabrun xhemil)!”** E pastaj tha: **“Unë dhimbjen time dhe pikëllimin tim ia paraqes vetëm Allahut.”** [Jusuf, 86]

¹⁸ Si shembuj se si të ruheni e të largoheni prej sulmuesit eventual me këto metoda.

¹⁹ Njëri nga dijetarët e njohur nga radhët e tabi'inëve, gjeneratës që ka ardhur pas sahabëve (shokëve) të të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me tël), teksa njëherë ishte duke lexuar suren Junus, Jusuf dhe Nahl, në namazin e sabahut, dhe kaloi nëpër këtë ajet, qau aq shumë saqë iu dëgjua rënkimi edhe në safat e fundit.

Kurse Musai ﷺ i lutej Zotit të Lartësuar me fjalët: “O Allah për Ty qoftë lavdi, Ty të ankohem, Ti je Ai që i ndihmon gjithkujt, me Ty jam i ndihmuar dhe nuk ka fuqi tjetër përveçse me Ty.”²⁰

Pejgamberi ,ﷺ në lutjen të cilën e bëri pasi që banorët e Taifit u sollën ashtu siç u sollën ndaj tij, tha: “O Allah, tek Ti ankohem për dobësinë time, për mosgjeturinë time dhe për mospranimin tim tek njerëzit. O i Gjithëmëshirshmi! Ti je Zot i të pafuqishmëve dhe i të dobëtëve, Ti je Zoti im. O Allah! Tek kush po më lë të mbështetem? Tek një i huaj që me fytyrë të mrrulur më pret? Apo tek një armik që është i preokupuar me çështjen në të cilën e thërras?! Nëse Ti nuk je i hidhëruar në mua, atëherë nuk brengosem për asgjë tjetër! Faljen Tënde e konsideroj të gjerë për mua. Kërkojë mbrojtje me Dritën e Fytyrës Tënde, me të cilën janë ndriçuar errësirat dhe janë rregulluar dynjaja dhe abireti, të mos më kaplojë hidhërimi dhe zemërimi Yt. Më nevojitet vetëm Mëshira dhe Kënaqësia Jote, nuk ka fuqi e as ndryshim, përveç Teje!”²¹

Dhe se herë që tek robi shtohet lakmia për mirësinë e Allahut dhe Mëshirën e Tij, dhe për aq sa i shtohet shpresa për plotësimin e nevojës që ka apo largimin e të keqes që e ka kapluar, i forcohet adhurimi i tij ndaj Zotit të Vetëm, dhe i shtohet pavarësia nga të tjerët pos Tij. Ngase, ashtu sikur që lakmia ndaj të mirave që mund të të sjellë një krijesë shkakton robërimin ndaj saj, ashtu edhe humbja e çdo shprese ndaj krijesave sjell pavarësinë e zemrës ndaj tyre.

²⁰ Është transmetuar në lajmet që kanë ardhur nge benu israilët, që quhen israiliate.

²¹ E ka transmetuar Ibn Is'haku në "Sira" (2/70).

E këtillë është edhe lakmia dhe shpresa që rob i ndaj Zotit të vet, ajo sjell robërimin (adhurimin) ndaj Tij. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَتَوَكَّلْ عَلَى الْحَيِّ الَّذِي لَا يَمُوتُ وَسَبِّحْ بِحَمْدِهِ وَكَفَى بِهِ بِذُنُوبِ عِبَادِهِ خَبِيرًا﴾

“Mbështetu në të Gjithëjetshmin, i Cili nuk vdes dhe madhëroje Atë me falënderim! Ai i di mjaft mirë gjynahet e robërve të Vet.” [Furkan, 58]

Prandaj duhet të dimë qartë se kushdo që e lidh zemrën e tij për ndonjë krijesë që ta ndihmojë, ta furnizojë apo ta udhëzojë, ajo zemër u është nënshtruar atyre, dhe njëkohësisht konsiderohet se u bëjnë ibadet atyre krijesave, siç mund të jenë udhëheqësit e tyre, kujdestarët e tyre, të cilët i llogarisin si furnizues të tyre, e në realitet Furnizuesi i vërtetë është vetëm Krijuesi, Allahu Fuqiplotë. Për këtë arsye njeriu mendjemprehtë duhet ta shikojë realitetin (Furnizuesin real) e jo të mashtrohet me formalitete të jashtme.

Që ta ilustrojmë këtë që thamë më sipër, mund të na shërbejë një burrë i cili e ka lidhur zemrën e tij për gruan e vet, edhe pse ajo është hallall për të, mirëpo robërimi i zemrës së tij ndaj gruas, në realitet e bën që ky burrë të jetë rob i gruas, edhe pse formalisht për sy e faqe të botës ky luan rolin e burrit. Pra, a ka më keq sa zemra të robërohet nga një krijesë tjetër. Ibadeti i zemrës dhe robërimi i saj është ajo çfarë ngarkohet me sevape dhe gjynahe (ndëshkime). Kurse nëse një musliman robërohet nga jobesimtari (armiku) ose nga një i shthurur (fasik), jo me fajin e vet, ai nuk ngarkohet me gjynahe edhe nëse i kryen obligimet që ia ngarkon armiku – ta zëmë nëse detyrohet të komunikojë me një jobesimtar - sepse në këtë rast zemra e tij është plot iman, prandaj ky nuk dëmtohet me asgjë. Vetëm robërimi i zemrës, pra bërja rob i tjetërkujt, e jo i Allahut, në çdo aspekt, është ajo që e dëmton njeriun, edhe nëse ky të ky person ka post mbreti.

Andaj, liria e vërtetë është liria e zemrës, ndërsa ibadet i vërtetë është ibadeti i zemrës, respektivisht kur ajo (zemra) i nënshtrohet madhërisë së Zotit të Lartësuar; ashtu sikur që pasuria e vërtetë është pasuria e shpirtit, siç thotë Pejgamberi :ﷺ “*Nuk është pasuri të kesh shumë mall, porse pasuri e vërtetë është pasuria e shpirtit.*” ²²

E sa i përket atij që zemra e tij është robëruar nga një pamje – gruaje apo të ngjashme –, kjo është dënim në vete, s’i afrohet dot asnjë dënim tjetër. Të këtillët janë njerëzit me dënimin më të madh (në këtë botë) dhe me më së paku shpërblim. Është kështu sepse kur dikujt i mbetet zemra e lidhur dhe e robëruar ndaj një pamje të caktuar, tek ai tubohen të gjitha llojet e të këqijave dhe shkatërrimit, saqë vetëm Zoti i gjithësisë ua di fundin, edhe po qe se i tilli ka shpëtuar prej veprës kryesore të imoralitetit, sepse kjo nënkupton vazhdimësinë e lidhjes së zemrës me atë gjë. Të këtillët janë të ngjashëm me pijanecët dhe të çmendurit. Ndërsa, prej shkaqeve më të mëdha të prekjes nga kjo fatkeqësi është largimi i zemrës nga Allahu, ngase kur zemra e shijon adhurimin e Allahut njëherë, dhe sinqeritetin ndaj Allahut, nuk mbetet diçka tjetër më e ëmbël, më e lezetshme dhe më e këndshme se këto. Njeriu nuk mund t’i largohet një sendi të dashur, përveç nëse gjen diçka më të dashur se ai, ose kur ka frikë nga ndonjë keqe që mund ta godasë. Së këndejmi, dashuria e rreme largohet prej zemrës vetëm atëherë kur vendin e saj e zë dashuria e sinqertë, apo frika nga ndonjë dëm që mund ta godasë nga e para. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿كَذَٰلِكَ لِنَصْرِفَ عَنْهُ السُّوءَ وَالْفَحْشَاءَ ۚ إِنَّهُ مِنْ عِبَادِنَا الْمُخْلَصِينَ﴾

“Kështu e larguam nga e keqja dhe vepra e shëmtuar, sepse ai, në të vërtetë, ishte nga robërit Tanë të sinqertë.” [Jusuf, 24]

²² Buhariu, 6446; Muslimi, 1051; Tirmidhiu, 2373, e të tjerë.

Pra, Allahu i Lartësuar e larguaka robin e Tij nga gjërat që i bëjnë dëm, siç është në këtë rast animi nga pamje të caktuara (ashikëri), apo lidhja e zemrës me to, si dhe e largon atë nga imoraliteti, përmes sinqeritetit të tij. Për këtë arsye, para se ta shijojë ëmbëlsinë e adhurimit ndaj Allahut të Lartësuar dhe sinqeritetin, robin e mposht vetja e tij për të pasuar egon, por, sapo të ketë provuar shijen e sinqeritetit dhe t'i forcohet në zemrën e tij, egoja e tij mposhtet e pashpresë. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ ۖ وَلَذِكْرُ اللَّهِ أَكْبَرُ ۗ﴾

“Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe!” [Ankebutë, 45]

Pra, falja e namazit njeriun jo vetëm se e largon nga të këqijat dhe gjërat e pështira, por me namaz (të sinqertë) njeriu arrin dobinë më të madhe, e ajo është afrimi tek i Dashuri (Allahu i Lartësuar). Andaj, arritja e njeriut deri te i Dashuri i tij (Allahu) llogaritet si ibadet më i madh se largimi i të keqes. Pra, përmendja e Allahut konsiderohet adhurim për Të, e adhurimi i zemrës ndaj Allahut është qëllim parësor (rrënjësor) i njeriut, ndërsa distancimi nga e keqja vjen në rend të dytë.

Zemra është krijuar për ta dashur të Vërtetën (Hakun), për ta kërkuar dhe synuar atë, andaj, kur u ballafaqua me dëshirën e egos për të keqen, zemra kërkoi që ta largojë tutje atë sepse ajo e prish zemrën sikurse krimbat që i prishin bimët. Për këtë arsye Allahu ka thënë:

﴿قَدْ أَفْلَحَ مَن زَكَّاهَا ۖ وَقَدْ خَابَ مَن دَسَّاهَا ۖ﴾

“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.” [Shems, 9-10]

Dhe ka thënë:

﴿قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى ۖ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى﴾

“I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!” [A’la, 14-15]

Gjithashtu ka thënë:

﴿قُلْ لِلْمُؤْمِنِينَ يَغُضُّوا مِنْ أَبْصَارِهِمْ وَيَحْفَظُوا فُرُوجَهُمْ ۚ ذَٰلِكَ أَرَكُمُ لَهُمْ ۖ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا يَصْنَعُونَ﴾

“Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më mirë për ta! Me të vërtetë, Allahu është i Dijshtëm për atë që bëjnë ata.” [Nur, 30]

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ مَا زَكَا مِنْكُمْ مِنْ أَحَدٍ أَبَدًا﴾

“Sikur të mos ishte mirësia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, askush nga ju nuk do të ishte pastruar kurrë (prej gjynaheve).” [Nur, 21]

Pra, uljen e shikimit dhe ruajtjen e organit gjenital (nga imoraliteti), Allahu i Lartësuar i përshkroi si më të pastra për shpirtin, pastaj tha se lënia e punëve të këqija (të ndyra) është pastrim i shpirtit (nefsit), për të vazhduar më tutje se pastrimi i nefsit ngërthen në vete zhdukjen e të gjitha të këqijave të tjera siç janë: imoraliteti, padrejtësia, shirku, gënjeshtria, etj. Ngjashëm, personi që lakmon pozitë (karrierë), respektivisht dëshiron të jetë i lartë në sipërfaqen e tokës (udhëheqës apo sundues), zemra e të këtillit është rob i atyre që e kanë shtyrë për të arritur në këto pozita, edhe pse formalisht duket sikur ai është prijësi dhe të gjithë i janë bindur atij. Ç’është e vërteta, i këtillit shpreson prej tyre dhe ua ka frikën,

harxhon pasuri të madhe për t'i ruajtur ata, duron ofendime të llojlojshme (bëhet kinse nuk i dëgjon), ky lloj udhëheqësi duket sikur është kryetar i ndjekur nga të gjithë, por në realitet nuk është tjetër pos një rob që u bindet atyre.

Prandaj personi i këtillë dhe grupi i përmendur, secili i bëjnë ibadet njëri-tjetrit, dhe që të dy palët kanë braktisur ibadetin ndaj Allahut të Lartësuar, dhe përderisa bashkëpunimi mes tyre është për t'u ngritur në pozita të larta në tokë padrejtësisht, ata, me fjalë të tjera janë në pozitën e atyre që ndihmojnë njëri-tjetrin në punë të ndyra, si cubë të rrugëve, e që rrjedhimisht, secili prej të dy palëve - për shkak të robërimit dhe skllavërisë që u ka shkaktuar pasimi i egos së tyre - janë bërë adhurues të njëri-tjetrit.

E njëjtë është edhe gjendja e kërkuesve të pasurisë, kjo gjë i bën ata robër dhe skllëvër.

Në fakt, këto gjëra ndahen në dy grupe:

1. Gjëra për të cilat njeriu ka nevojë, si ushqimi, pija, banimi, martesë, etj. Këto gjëra duhet lypsur prej Allahut të Lartësuar, dhe vetëm tek Ai duhet varur shpresat për to. Në këtë mënyrë pasuria të cilën ai e përdorë për nevojat e veta, i ngjason gomarit (mjetit të udhëtimit) të cilin ai e përdorë për t'i grahur, shtrojës mbi të cilën ulet, madje i ngjason nevojtores të cilën e përdorë për t'i kryer nevojat fiziologjike; pa kurrfarë robërimi (a skllavërie) që i sjell vetëm dëshpërim. Siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿ إِذَا مَسَّهُ الشَّرُّ جَزُوعًا ۖ وَإِذَا مَسَّهُ الْخَيْرُ مَنُوعًا ۚ ﴾

“... kur atë e godet e keqja, ai ligështohet fort, por, kur i bie e mira, ai bëhet koprrac.” [Mearixh, 20-21]

2. Gjëra për të cilat njeriu s'ka nevojë, e që rrjedhimisht nuk ia vlen që të lidhet zemra për to, e në qoftë se zemra lidhet për to,

atëherë shndërrohet në adhuruese të tyre, e ndoshta edhe mbështetet në to e jo në Allahun, saqë nuk i mbetet në veten e tij më asnjë shenjë e adhurimit ndaj Allahut të Lartësuar, e as mbështetjes në Të, madje në zemrën e tij ka degë të adhurimit të dikujt tjetër pos Allahut, degë të mbështetjes në dikë tjetër pos në Allahun, saqë, të këtillit, më së shumti i shkon për shtati fjala e Pejgamberit ﷺ (që u cek më lart): *“Është shkatërruar rob i dinarit dhe i dërbemit, e rob i shtrojave dhe petkave.”*

Pra, rob i gjërave të lartcekura, edhe sikur t'i kishte kërkuar Allahut të Lartësuar ato gjëra, ai do të ndihej i kënaqur vetëm nëse Allahu do t'ia jepte ato, por, po qe se nuk do t'ia jepte, do të hidhërohej. Mirëpo, rob i vërtetë i Allahut është ai i cili kënaqet me atë që e kënaq Allahun e Lartësuar, dhe e hidhëron ajo që Allahun e hidhëron, e do atë që Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan, dhe e urren atë që Allahu dhe i Dërguari i Tij e urrejnë, kurse shoqërues i ka ata që janë evlija (të dashur) të Allahut, e armiq i ka armiq të Allahut të Lartësuar.

Pra, vetëm i këtilli është ai i cili e ka plotësuar imanin (besimin), siç është thënë në hadith se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Ai që do dikë për hir të Allahut, e urren dikë për hir të Allahut, jep për hir të Allahut, nuk jep (aty ku s'dubet) për hir të Allahut, i tilli e ka plotësuar imanin.”*²³ Po ashtu, në hadith është thënë: *“Nyjat më të forta të imanit janë: Dashuria për hir të Allahut dhe urrejtja për hir të Allahut.”*²⁴ Kurse në Sahihun e Buhariut është transmetuar se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Ai që i ka këto tri cilësi, e ka shijuar ëmbëlsinë e imanit: që Allahu dhe i Dërguari i Tij*

²³ E transmeton Ebu Davudi, 4681; Taberaniu në ”Muxhem el kebir,” 7613, 7737; Begaviu (13/54); me zinxhir të mirë (hasen), nga Ebu Uname.

²⁴ Hadithi është i mirë (hasen) dhe është transmetuar nga rrugë të ndryshme, më e sigurta e tyre është transmetimi i Tabariniut në ”Muxhem el kebir”, 10357, nga Ibn Mesudi, me zinxhir të mirë.

Dallimet sipas imanit (besimit)

të jenë më të dashur tek ai se çdo gjë tjetër, që të dojë një person vetëm për hir të Allahut, që të urrejë kthimin në mosbesim ashtu siç urren të hidhet në Zjarr.”²⁵

Pra, i këtilli i është përshtatur Zotit të tij në gjërat që duhet t'i dojë dhe në gjërat që duhet t'i urrejë, sepse Allahu dhe i Dërguari i Tij ﷺ janë më të dashur për të se çdo gjë tjetër, se i do krijesat vetëm për hir të Allahut dhe për asgjë tjetër, rrjedhimisht ky është plotësimi i dashurisë së Tij për Allahun, ngase ta duash të dashurin e të dashurit, është plotësim i dashurisë ndaj të dashurit. Me dashurinë e tij ndaj pejgamberëve të Allahut dhe të dashurve të Allahut, për shkak se këta të gjithë i qëndrojnë besnikë gjërave që Allahu i do, dhe për asgjë tjetër, atëherë i bie se i ka dashur vetëm për hir të Allahut, e jo për diçka tjetër. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿ فَسَوْفَ يَأْتِي اللَّهُ بِقَوْمٍ يُحِبُّهُمْ وَيُحِبُّونَهُ أَذِلَّةٍ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ أَعِزَّةٍ عَلَى الْكَافِرِينَ ﴾

“(Atëherë) Dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përlur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit.” [Maide, 54]

Dhe mu për këtë arsye Allahu ka thënë:

﴿ قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴾

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.” [Ali Imran, 31]

Pra, meqenëse i Dërguari ﷺ urdhëron për gjëra që Allahu i do dhe ndalon prej gjërave që Allahu i urren, si dhe i vepron vetë ato

²⁵ Buhariu, 16.

gjëra që Allahu i do, atëherë Pejgamberi ﷺ po na informon se cilat janë ato gjëra që Allahu kërkon prej nesh t'iu besojmë (pasojmë).

Kështu pra, kush e do Allahun, patjetër kërkohet prej tij që ta pasojë të Dërguarin, ﷺ t'i besojë atij në gjërat që tregon, t'i bindet në urdhrat që jep, ta merr si model në gjërat që i vepron, e për pasojë, kush vepron kështu, ka bërë ato gjëra që Allahu i do, rrjedhimisht ai bëhet i dashur tek Allahu.

Allahu i Lartësuar i ka dalluar të dashurit e vet me dy shenja:

1. Ata e pasojnë Pejgamberin ﷺ dhe
2. Ata luftojnë (xhihad) në rrugën e Tij.

Sepse fjala xhihad në realitet do të thotë angazhim dhe përpjekje për të arritur atë që Allahu i Lartësuar e do, siç është: imani, veprat e mira dhe të larguarit prej gjërave që Allahu i Lartësuar i urren, si: kufri (mosbesimi), shthurja, mëkatet, etj. E këto më së miri i ilustronjë fjalët e Allahut të Lartësuar:

﴿قُلْ إِنْ كَانَ آبَاؤُكُمْ وَأَبْنَاؤُكُمْ وَإِخْوَانُكُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ وَعَشِيرَتُكُمْ وَأَمْوَالٌ
اَفْتَرَقْتُمُوهَا وَتِجَارَةٌ تَخْشَوْنَ كَسَادَهَا وَمَسَاكِينُ تَرْضَوْنَهَا أَحَبَّ إِلَيْكُمْ مِنَ اللَّهِ
وَرَسُولِهِ وَجِهَادٍ فِي سَبِيلِهِ فَتَرَبَّصُوا حَتَّى يَأْتِيَ اللَّهُ بِأَمْرِهِ ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ
الْفَاسِقِينَ﴾

“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.” [Tevbe, 24]

Pra, Allahu i Lartësuar u ka premtuar dënim atyre që e kanë më të dashur: mallin, familjen etj., sesa Allahun dhe të dërguarin e Tij,

si dhe xhihadin në rrugën e Tij. Madje, në hadithin sahih është vërtetuar se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *"Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, nuk ka besuar asnjëri prej jush, derisa të jem më i dashur për të sesa prindi e fëmija i tij, si dhe krejt njerëzimi."*²⁶

Po ashtu, në një hadith tjetër sahih transmetohet se Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "O i Dërguari i Allahut, ti je më i dashur për mua se çdo gjë tjetër, përpos vetes sime." Pejgamberi ﷺ në atë rast i tha: *"Jo, o Omer!, betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, derisa të bëhem më i dashur për ty sesa vetja jote."* Atëherë Omeri (pasi u mendua pakëz) tha: "Tash po, për Allahun! Tani ti je më i dashur për mua sesa vetja ime." - *"Tani po, o Omer!"*²⁷ - i tha Pejgamberi ﷺ.

Pra, dashuria e vërtetë nuk plotësohet ndryshe përveçse duke iu afruar të dashurit, e që do të thotë ta duash atë që Allahu i Lartësuar e do dhe ta urresh atë që Allahu e urren, e Allahu e do imanin dhe devotshmërinë, ndërsa e urren kufrin, punët e mbrapshta dhe mëkatet. Siç është e ditur, dashuria e këtillë e vë në lëvizje edhe dëshirën e zemrës, saqë, sa më shumë që të forcohet kjo dashuri në zemër, aq më shumë zemra e këtillë kërkon të bëjë vepra edhe më të dashura, respektivisht nëse dashuria e këtillë është e plotë, atëherë edhe zemra e ka dëshirën e arritjes së plotë deri tek veprat e dashura; kështu, nëse robi është i aftë atëherë arrin ta realizoi këtë, e nëse nuk është i aftë aq sa duhet, atëherë të këtillit i shkruhet sevapi sikur t'i ketë punuar ato vepra, për shkak se ka dhënë mundin maksimal. Po ashtu, Pejgamberi ﷺ ka thënë: *"Kush thërret në udhëzim, do të ketë shpërblim aq sa kanë edhe ata që e pasojnë, pa u zvogëluar aspak shpërblimi i atyre, por edhe kushdo që thërret në lajthitje do të ketë mëkat po aq sa kanë edhe ata që e pasojnë, pa u zvogëluar aspak mëkati i tyre."* Ndërsa në një hadith tjetër thotë: *"Në Medinë janë disa persona, të cilët kanë qenë me ju*

²⁶ Buhariu, 15; Muslimi, 44; Nesaiu (8/144); nga Enesi.

²⁷ Buhariu, 6632.

në çdo shteg dhe luginë që kalonit.” Ata thanë: "O i Dërguari i Allahut, a edhe duke qenë në Medinë?" - Po, edhe duke qenë në Medinë, ngase pamundësia i ka privuar (të na bashkohen)”,²⁸ - tha Pejgamberi ﷺ.

Pra xhihad është: përpjekja maksimale e njeriut për të arritur dashurinë e të Vërtetit absolut (Hakut)²⁹ dhe largimi nga ajo që i Vërteti (Hakun) e urren. Përndryshe, nëse robi e braktis xhihadin të cilin ka mundësi ta veprojë, kjo dëshmon për dobësinë e dashurisë që ka në zemër për Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ, sepse, dihet mirëfilli se në shumicën e rasteve, gjërat e dashura nuk arrihen ndryshe pos duke iu bërë ballë punëve të urryera (për egon), pa marrë parasysh a është fjala për gjërat e dashura që ia vlen të sakrifikohet për to apo që nuk janë të këtilla. (Madje, edhe sipas parimeve të kësaj bote) Ata të cilët janë të dhënë pas ndonjë pasurie, posti apo ashikërie, ata nuk mund t'i arrijnë dot kërkesat e tyre pa përjetuar telashe (vështirësi) në rrugën e tyre, pa e llogaritur të keqen që mund t'i godasë gjatë rrugës në këtë dynja, e pastaj në ahiret.

Për këtë arsye, ai që e do Allahun dhe Pejgamberin e Tij, nëse nuk ia del dot të përballojë ato vështirësi, të cilat, ata që punojnë për dikë tjetër pos Allahut i konsiderojnë të përballueshme, atëherë i bie që dashuria e tij për Allahun është e dobët, ngase ata që i përballojnë këto pengesa, është mendja e tyre ajo që i udhëzon se patjetër duhet të arrihet deri tek to. Kurse, në anën tjetër, dihet mirëfilli se besimtari e do Allahun më shumë se ata, siç ka thënë i Lartësuar:

﴿وَمِنَ النَّاسِ مَن يَتَّخِذُ مِنْ دُونِ اللَّهِ أَندَادًا يُحِبُّونَهُمْ كَحُبِّ اللَّهِ وَالَّذِينَ آمَنُوا أَشَدُّ حُبًّا لِلَّهِ وَلَوْ يَرَى الَّذِينَ ظَلَمُوا إِذْ يَرْوْنَ الْعَذَابَ أَنَّ الْقُوَّةَ لِلَّهِ جَمِيعًا وَأَنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعَذَابِ﴾

²⁸ Buhariu, 4423.

²⁹ Njëri prej Emrave të Allahut të Lartësuar është Hak – i Vërteti absolut.

“E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu. Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (se sa ç’i duan idhujtarët idhujt e tyre). Sikur keqbërësit të shihnin që tani çastin kur të përballen me ndëshkimin, do ta kuptonin se e tërë fuqia i përket Allahut dhe se dënimi i Tij është fort i ashpër.” [Bekare, 165]

Po; ka mundësi që i dashuruari i këtillë, për shkak të dobësisë së mendjes së tij dhe vizionit të tij të çrregulluar, t’i përmbahet një rruge (metode) përmes së cilës nuk ka mundësi të arrihet qëllimi i kërkuar; porse, një rrugë e tillë, edhe nëse dashuria është e drejtë dhe e lavdëruar, nuk pëlqehet, e çfarë të themi kur vetë dashuria është e kotë, kurse rruga është qorre?! Shembull i kësaj janë njerëzit të cilët kërkojnë pasuri, pozitë e ashikëri, dashuri të këtilla që u sjellin vetëm zarar (dëm)³⁰, dhe në fund, nuk arrijnë ta realizojnë dëshirën e tyre. Ajo që e kemi për qëllim janë rrugët që i ndjek mendja e shëndoshë për arritjen deri tek qëllimet e saj.

Andaj, pasi sqaruar këtë dallim, mund të themi se sa më shumë që shtohet dashuria ndaj Allahut të Lartësuar, aq më shumë shtohet edhe dëshira (në zemrën e robit) për ibadet ndaj Tij; dhe anasjelltas, sa më shumë të shtohet ibadeti ndaj Tij, aq më shumë shtohet dashuria ndaj Tij, dashuri që e vlerëson më shumë se çdo dashuri tjetër.

Pra, zemra, në thelb është e varfër dhe ka nevojë për Allahun e Lartësuar në dy aspekte:

1. Në aspektin e nevojës për ta adhuruar dikë (ibadetit); e që është shkaku final (për të cilin Allahu i ka krijuar krijesat), dhe

³⁰ Siç thotë populli: "Më shumë zarari se qari (fitimi)"

2. Në aspektin e nevojës për të kërkuar ndihmë dhe mbështetje nga dikush, e që është shkaku funksional (që mundëson realizimin e ibadetit).

Pra, zemra nuk u ndreqka, nuk shpëtuaka, nuk u kënaqka, nuk u gëzuaka, nuk u përmirësuaka, nuk pushuaka dhe as u qetësuaka ndryshe, përveçse me idabet dhe dashuri ndaj Zotit të saj, si dhe me pendesë të vazhdueshme tek Ai; Prandaj, edhe po qe se i arrin të gjitha kënaqësitë e tjera përmes krijesave, ajo zemër prapëseprapë nuk do të qetësohet e as prehet tek diçka tjetër, sepse në brendësi të saj ka një varfëri (zbrazëti) qenësore, të cilën e ndjen ndaj Zotit të vet (Allahut), për shkak se vetëm Ai është i adhuruari i vërtetë i saj (zemrës), i dashuri i vërtetë, qëllimi i vërtetë, dhe vetëm përmes Tij mund të arrijë gëzimin, kënaqësinë, pushimin, begatitë, prehjen dhe qetësinë e plotë.

Nga kjo mund të konstatojmë se mbështetja e zemrës tjetërkund nuk mund të sjellë dot këto gjëra (nevoja), por Ai që mund t'ia sjellë robit këto është vetëm Allahu; kurse robi do të jetë gjithmonë i varur nga realiteti i ajetit:

﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” [Fatiha, 5]

Edhe sikur robi të ndihmohej për t'i arritur gjërat që ai i dëshiron, i kërkon, i pëlqen dhe i synon, duke mos ngjarë prej anës së tij ndonjë adhurim ndaj Allahut, ai s'do të kishte mundësi t'i arrinte ato përveçse pas dhimbjeve, dëshpërimeve, ndëshkimeve, dhe asnjëherë nuk do të shpëtonte nga dhimbjet e dynjasë dhe vështirësitë e jetesës në të, përveç përmes dashurisë së sinqertë ndaj Allahut, duke e bërë vetëm Atë qëllimin final të dëshirave të tij, destinacionin e qëllimit të tij, ngase Ai është i adhuruari i tij në vend të parë, kurse çdo gjë tjetër që robi do, e do për shkak të këtij qëllimi parësor,

respektivisht, nuk do asgjë për hir të vetë asaj gjëje, por vetëm për hir të Allahut të Lartësuar.

Andaj, përderisa robit nuk i ka ngjarë kjo, i bie se ende nuk ka arritur të vërë në praktikë realitetin e dëshmisë “La ilahe ilallah” - s’ka të adhuruar të denjë përveç Allahut -, e as ta vërë në praktikë tevhidin³¹, adhurimin dhe dashurinë ndaj Allahut, dhe tek ai ekziston mangësi në tevhid dhe iman – madje e shoqëruar me dhimbje, dëshpërim dhe ndëshkim – në proporcion të drejtë me këtë. E nëse përpiqet për të arritur këtë qëllim, por pa kërkuar ndihmë prej Allahut, pa u mbështetur tek Ai dhe pa shfaqur nevojë për Të, nuk do t’ia dalë; ngase vetëm ajo që do Allahu ndodh, e ajo që Ai nuk do, nuk ndodh, kështu që robi është gjithmonë nevojtar për Allahun, duke pasur parasysh se Ai është synimi ynë, i Dashuri ynë, qëllimi ynë, i adhuruari ynë, dhe, përderisa Ai pyetet për gjithçka, atëherë vetëm tek Ai kërkojmë ndihmë, vetëm tek Ai mbështetemi, ai është i Adhuruari i robit, s’ka të adhuruar tjetër të denjë përveç Atij, e as ka zot tjetër pos Tij.

Pra, ibadeti i robit ndaj Allahut nuk arrihet përveçse përmes këtyre dyjave që i cekëm. Me fjalë të tjera, sa herë që e do dikë tjetër përveç Allahut, jo për hir të Allahut por për hir të vetë asaj krijese, apo kthen kokën kah të tjerët pos Allahut që t’i ndihmojnë, bëhet rob i tij për shkak se e ka dashur dhe rob i tij për shkak se ka shpresuar prej tij, varësisht prej sasisë së dashurisë ndaj tij dhe varësisht prej shpresës prej tij. Kurse, sa herë që e do dikë vetëm për hir të Allahut dhe për asgjë tjetër, dhe çdo gjë tjetër që e do, e do për hir të Allahut, si dhe nuk shpreson kurrë prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut; po ashtu: sa herë t’i ketë vepruar shkaqet e nevojshme për të arritur deri te një qëllim i tij, apo sa herë t’i ketë ngjarë ajo që i ka ngjarë, dëshmon se Allahu është Ai që i ka krijuar të gjitha ato shkaqe, i ka përcaktuar të ndodhin, ia ka nënshtruar atij, dhe se çdo

³¹ Njësimin e Allahut në adhurim, duke mos i bërë shok askënd.

gjë që ndodhet në qiell dhe në tokë, Allahu është Zot i tyre, pronar i tyre, krijues i tyre, nënshtrues i tyre për robin, gjë që e bën robin të jetë nevojtar për Të; vetëm atëherë ia ka dalë që ta plotësojë UBUDIJEN (adhurimin) e plotë të tij ndaj Allahut, në raport me atë që i është caktuar për hise nga të gjitha këto që i përmendëm më lart.

S'do mend se njerëzit në këtë aspekt u përkasin shkallëve të ndryshme, sa vetëm Allahu e di numrin e rrugëve që ata ndjekin për t'i arritur këto. Por, njeriu më i plotësuar, më i mirë, më i lartë dhe më i afërt me Allahun, më i forti dhe më i udhëzuar, është ai që ka plotësuar më së shumti këtë adhurim ndaj Allahut, sipas asaj që thamë.

Mendjemadhësia (kibri) shlyen ibadetin e vërtetë

Ky është realiteti i dinit Islam të cilin Allahu e solli me pejgamberët e Vet dhe e shpalli në Librat e Tij, e që do të thotë se robi duhet t'i nënshtrohet Allahut, dhe askujt tjetër pos Tij, dhe se ai që i nënshtrohet Atij por edhe dikujt tjetër, ka bërë shirk (politeizëm), sakaq ai që shmanget nga nënshtrimi ndaj Tij është bërë mendjemadh.

Në Sahihun e Muslimit është transmetuar se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Nuk do të hyjë në Xhenet ai që në zemrën e tij posedon mendjemadhësi qoftë dhe sa një grimcë.”*³² Ashtu sikur që, nuk do të mbetet përgjithmonë në Zjarr ai që në zemrën e tij posedon besim (iman) qoftë edhe sa një grimcë. Pra, Pejgamberi ﷺ mendjemadhësinë (krenarinë) e ka vënë në të kundërtën e besimit, sepse mendjemadhësia bie në kundërshtim me thelbin e adhurimit. Po ashtu, në hadith tjetër sahih Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Krenaria është petku i Allahut, kurse Madhështia është petku i sipërm i Tij, andaj (Allahu thotë:) kushdo që më ndërhyjnë në to, do ta dënojmë!”*³³

Nga kjo që u tha më sipër, mjafton të bindemi se madhështia dhe krenaria janë dy cilësi të Allahut Fuqiplotë, ndërkohë krenaria ia tejkalon madhështisë, andaj kjo është arsyeja pse e dyta është krahasuar me petkun e sipërm, kurse krenaria me petkun e zakonshëm. Për këtë arsye, madhërimi i Allahut (tekbiri)³⁴ është bërë simbol i namazit, ezanit dhe bajrameve, e po ashtu, është e pëlqyer të thuhet edhe gjatë hipjes në vende të larta: siç janë kodrat Safa dhe Merva, apo kur njeriu ngrihet në pozitë, apo hipën në kafshën e tij (mjetin e udhëtimit), e gjëra të ngjashme; madje me thënien ”Allahu

³² Muslimi, 91; Tirmidhiu, 1998; Ebu Davudi, 4091, Ibn Maxhe, 59, 4173; Taberaniu në ”El Kebir”, 10000; nga Ibn Mesudi.

³³ Muslimi, 2620, nga Ebu Seid Hudriu dhe Ebu Hurejra.

³⁴ Thënia ”Allahu Ekber”, e cila ndryshe quhet tekbir.

Ekber” shuhet çdo zjarr edhe nëse është i madh; kurse, në kohën e ezanit, shejtani ikën prej kësaj fjale. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي
سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ﴾

“Zoti juaj ka thënë: “Lutmuni Mua, do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar!” [Gafir, 60]

Pas të gjitha këtyre që u cekën, mund të konstatohet se çdokush që paraqitet mendjemadh para Allahut të Lartësuar, ai person është adhurues i tjetërkujt (pos Allahut), sepse si krijesë, njeriu është i ndjeshëm, vihet në lëvizje nga synimi (qëllimi final) që ka. Madje është transmetuar se Pejgamberi ﷺ ka thënë: *“Emrat më të vërtetë janë: Harith dhe Hemam.”* Sa i përket emrit Harith, në arabisht ka ardhur në trajtën e thjeshtë të mbiemrit (fail), që nënkupton: fitues, punëtor. Kurse emri Hemam ka ardhur në trajtën më të lartë të sipërores (fe’alun) nga folja “hemme” - dashje, synim. Kështu, kjo folje shpreh shkallën e parë të dashjes, ndërkohë dihet mirëfilli se njeriu dashjen e ka të vazhdueshme, dhe çdo dashjeje (synimi) i duhet një qëllim final të cilin do ta arrijë.³⁵

Prandaj, çdo rob patjetër që ka një qëllim final që e dashuron, i cili pasqyron kulmin e dashurisë dhe synimit të tij. Andaj, nëse nuk është Allahu i adhuruari i tij dhe kulmi i dashurisë dhe qëllimit të tij - por ai bëhet mendjemadh ndaj kësaj - atëherë, gjithsesi ai duhet të ketë një pikësynim tjetër të dashurisë ndaj të cilit shpreh adhurimin e tij pos Allahut të lartësuar, gjë që e bën rob të këtij të dashuri të tij

³⁵ Pra, Pejgamberi ﷺ ka treguar se cilësitë apo veçoritë më të sakta që tregojnë natyrën e vërtetë të njeriut janë këta dy emra, krijesë që punon për të fituar (harith), dhe krijesë që posedon shkallën superiore të dashjes (synimit), cilësi kjo që e përcjell vazhdimisht deri në vdekje.

që e ka marrë për qëllim final; qoftë kjo gjë pasuri, qoftë famë (prestigi), qoftë ashikëri; apo gjëra tjera që i ka marrë për të adhuruar si: dielli, hëna, yjet, idhujt, varret e pejgamberëve dhe njerëzve të devotshëm, apo vetë melekët dhe pejgamberët të cilët i kanë marrë për zota, apo çfarëdo gjëje tjetër që mund të adhurohet pos Allahut Fuqiplotë.

Duke u bërë rob i dikujt tjetër pos Allahut, i tilli bëhet mushrik (idhujtar), rrjedhimisht, çdo mendjemadh është edhe idhujtar. Kjo e sqaron edhe faktin pse Faraoni ka qenë krijesa me mendjemadhësinë më të madhe në raport me adhurimin e Allahut, njëkohësisht ishte idhujtar. Allahu i Lartësuar thotë për të:

﴿وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مُوسَىٰ بِآيَاتِنَا وَسُلْطَانٍ مُّبِينٍ ۖ إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَهَامَانَ وَقَارُونَ فَقَالُوا سَاجِدْ كَذَّابٌ ۝... إِلَىٰ قَوْلِهِ: ﴿وَقَالَ مُوسَىٰ إِنِّي عُذْتُ بِرَبِّي وَرَبِّكُمْ مِنْ كُلِّ مُتَكَبِّرٍ لَا يُؤْمِنُ بِيَوْمِ الْحِسَابِ﴾ ... وَإِلَىٰ قَوْلِهِ: ﴿كَذَٰلِكَ يَطْبَعُ اللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ قَلْبٍ مُتَكَبِّرٍ جَبَّارٍ﴾

“Më parë Ne e dërguam Musain me mrekullitë Tona dhe me një autoritet të qartë, te Faraoni, Hamani dhe Karuni, por ata thanë: “Ky është magjistar dhe gënjeshtar!” deri te Fjala e Allahut: “Musai tha: “Unë i lutem Zotit Tim dhe Zotit tuaj për të më mbrojtur prej çdo mendjemadhi, që nuk beson në Ditën e Llogarisë!”, e deri te Fjala e Tij: “Kështu, Allahu ia vulos zemrën çdo mendjemadhi e dhunuesi”. [Gafir, 23-35]

I Lartësuari po ashtu ka thënë:

﴿وَقَارُونَ وَفِرْعَوْنَ وَهَامَانَ طَوَّلُوا لَقَدْ جَاءَهُمْ مُوسَىٰ بِالْبَيِّنَاتِ فَاسْتَكْبَرُوا فِي الْأَرْضِ وَمَا كَانُوا سَابِقِينَ﴾

“Kështu ndodhi edhe me Karunin, Faraonin dhe Hamanin! Atyre u vajti Musai me prova të qarta, por ata treguan mendjemadhësi në Tokë dhe nuk i shpëtuan dënimit.” [Ankebutë, 39]

Po ashtu ka thënë:

﴿ إِنَّ فِرْعَوْنَ عَلَا فِي الْأَرْضِ وَجَعَلَ أَهْلَهَا شِيَعًا يَسْتَضِعُّ طَائِفَةً مِنْهُمْ يُدَبِّحُ
أَبْنَاءَهُمْ وَيَسْتَحْيِي نِسَاءَهُمْ إِنَّهُ كَانَ مِنَ الْمُفْسِدِينَ ﴾ إلى قوله: ﴿فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ
عَاقِبَةُ الظَّالِمِينَ﴾

“Me të vërtetë që Faraoni madhështojë në Tokë dhe banorët e saj i kishte përçarë në grupe; disa prej tyre i përndiqte, ua vriste fëmijët meshkuj, ndërsa femrat ua linte gjallë. Ai ka qenë vërtetë keqbërës.” e deri te Fjala e Tij: “Shiko se cili ishte fundi i keqbërësve!” [Kasas, 4, 40]

Allahu ka thënë:

﴿ وَجَدُوا بِهَا وَاسْتَيْقَنَتْهَا أَنْفُسُهُمْ ظُلْمًا وَعُلُوًّا فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ
الْمُفْسِدِينَ ﴾

“Kështu, ata i mohuan ato (argumentet) padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërtetë. Pa shiko, cili ka qenë fundi i shkatërrimtarëve!” [Neml, 14]

Të këtillë shembuj ka shumë në Kuran. Allahu e ka përshkruar Faraonin si idhujtar edhe në Fjalën e Tij:

﴿ وَمَا تَنْقِمُ مِنَّا إِلَّا أَنْ آمَنَّا بِآيَاتِ رَبِّنَا لَمَّا جَاءَتْنَا ۚ رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا
وَتَوَقَّنَا مُسْلِمِينَ ﴾

“Paria e popullit të Faraonit tha: “A mos vallë do ta lësh Musain dhe popullin e tij që të bëjnë ngatërresa në tokë dhe që të braktisin ty dhe zotat e tu?” [Arafë, 127]

Studimi i të gjitha argumenteve të kësaj në natyrë na sjell në një përfundim se njeriu sa më mendjemadh që bëhet në raport me adhurimin e Allahut Fuqiptotë, aq më shumë do t'i shoqërojë të tjerë në adhurim (do t'i bëjë shirk), sepse me largimin e robit nga

adhurimi i Allahut, ai varfërohet pa masë (shpirtërisht) dhe bëhet gjithnjë e më shumë i varur prej tjetërkujt, varësisht prej atij që e konsideron qëllimin e tij final të cilin e do, i cili ka zënë vend në zemrën e tij e që, siç kemi theksuar më parë, është qëllim i tij parësor e caku i tij i i fundit. Kështu, pra bëhet idhujtar (pagan), respektivisht bëhet rob i atij që e ka robëruar (bëhet rob i robit).

Që të mos ndodh kjo, pra robërimi (adhurimi) i njeriut ndaj një krijese tjetër si ai, njeriu duhet të kthehet e të drejtohet vetëm nga Krijuesi i vet, Allahu, pos të cilit nuk adhuron dikë tjetër, përveç të Cilit askujt tjetër nuk i kërkon ndihmë e as i mbështetet, nuk gëzohet me diçka tjetër, pos me atë që Allahu e do dhe është i Kënaqur me të, nuk urren përveçse atë që Zoti e urren dhe hidhërohet me të, nuk merr për të dashur dhe të afërt (evlija) përveç atyre që Allahu i ka marrë për evlija, dhe nuk armiqëson përveçse ata që Allahu i ka armiqësuar; nuk do dikë përveçse për hir të Allahut dhe nuk urren dikë pos për hir të Tij, si dhe jep vetëm për hir të Allahut dhe e privon dikë nga pasuria e tij vetëm për hir të Tij. Kështu, sa më shumë që forcohet sinqeriteti i fesë së Tij ndaj Allahut, aq më shumë plotësohet adhurimi i tij dhe pavarësia nga krijesat e Tij; kurse me plotësimin e adhurimit të tij ndaj Allahut, plotësohet edhe distancimi i tij nga mendjemadhësia - si cilësi e hebrenjve - dhe shirku – si cilësi e të krishterëve.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿ اتَّخَذُوا أَحْبَارَهُمْ وَرُهَبَانَهُمْ أَرْبَابًا مِّن دُونِ اللَّهِ وَالْمَسِيحَ ابْنَ مَرْيَمَ وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا إِلَهًا وَاحِدًا ۚ لَّا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۚ سُبْحَانَهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ۝﴾

“Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes, ndërkohë që janë urdhëruar të adhurojnë vetëm një Zot, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë (në adhurim).” [Tevbe, 31]

Po ashtu ka thënë:

﴿ أَفَكُلَّمَا جَاءَكُمْ رَسُولٌ بِمَا لَا تَهْوَىٰ أَنفُسُكُمْ اسْتَكْبَرْتُمْ فَفَرِيقًا كَذَّبْتُمْ وَفَرِيقًا تَقْتُلُونَ ﴾

“Vallë, sa herë që ndonjë i dërguar ju sillte atë që nuk ju pëlqente, ju kapardiseshit, pastaj disa i quanit gënjeshtarë e disa i vritnit?!” [Bekare, 87]

I Lartësuari po ashtu tha:

﴿ سَأَصْرِفُ عَنْ آيَاتِيَ الَّذِينَ يَتَكَبَّرُونَ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ وَإِنْ يَرَوْا كُلَّ آيَةٍ لَا يُؤْمِنُوا بِهَا وَإِنْ يَرَوْا سَبِيلَ الرُّشْدِ لَا يَتَّخِذُوهُ سَبِيلًا وَإِنْ يَرَوْا سَبِيلَ الْعِزِّ يَتَّخِذُوهُ سَبِيلًا ﴾

“Do t’i largoj prej shenjave të Mia ata që sillen me arrogancë në Tokë, kështu që edhe kur të shohin çfarëdo shenje, nuk do ta besojnë atë. Kur të shohin rrugën e drejtë, ata nuk do ta ndjekin atë dhe, kur të shohin rrugën e gabuar, do ta marrin atë.” [Arafë, 146]

Duke qenë se mendjemadhësia është dangë (ngjyrosje) e shirkut, kurse shirku është e kundërta e Islamit, madje mëkati të cilin Allahu kurrë nuk e falë, Allahu tha:

﴿ إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ۚ وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ افْتَرَىٰ إِثْمًا عَظِيمًا ﴾

“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm.” [Nisa, 48]

Dhe ka thënë:

﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ۚ وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا بَعِيدًا﴾

“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ai me të vërtetë, ka humbur dhe është larguar shumë prej udhës së drejtë.” [Nisa, 116]

Të gjithë peygamberët janë dërguar me dinin Islam, din ky që është i vetmi i pranuar te Allahu i Lartësuar, si prej të parëve ashtu edhe prej të fundmëve. Kjo shihet edhe nga fjalët e të gjithë peygamberëve, duke filluar nga Nuhu ,ﷺ i cili tha:

﴿فَإِنْ تَوَلَّيْتُمْ فَمَا سَأَلْتُكُمْ مِنْ أَجْرٍ ۖ إِنِّي أَخْرَجْتُ إِلَّا عَلَى اللَّهِ ۚ وَأُمِرْتُ أَنْ أَكُونَ مِنَ الْمُسْلِمِينَ﴾

“Por, nëse ktheni shpinën, (dijeni se) unë prej jush nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi. Shpërblimi im është vetëm tek Allahu. Mua më është urdhëruar të jem prej muslimanëve (të nënshtruarve).” [Junus, 72]

Pastaj në ajetet 130, 131 dhe 132 të sures Bekare, Allahu i Lartësuar thotë, duke cituar Ibrahimin ,ﷺ:

﴿وَمَنْ يَرْغَبْ عَنْ مِلَّةِ إِبْرَاهِيمَ إِلَّا مَنْ سَفِهَ نَفْسَهُ ۚ وَلَقَدِ اصْطَفَيْنَاهُ فِي الدُّنْيَا ۚ وَإِنَّهُ فِي الْآخِرَةِ لَمِنَ الصَّالِحِينَ ۚ إِذْ قَالَ لَهُ رَبُّهُ أَسْلِمْ ۖ قَالَ أَسْلَمْتُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ ۚ إِلَى قَوْلِهِ: ﴿فَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ﴾

“Fesë së Ibrahimit i shmanget vetëm ai që e nënçmon vetveten. Ne e zgjodhëm atë në këtë botë, kurse në botën tjetër ai do të jetë ndër të mirët. Kur Zoti i tij i tha: “Përulu!” - ai u përgjigj: “Ju përula Zotit të gjithësisë!” e deri te fjalët: ...

“... prandaj mos vdisni ndryshe veçse duke qenë myslimanë (të nënshtruar ndaj Atij)!” [Bekare, 130-132]

Po ashtu, Jusufi ﷺ tha: “Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)!”³⁶ Musai ﷺ tha: “O populli im! Nëse besoni Allahun, mbështetuni tek Ai, nëse jeni myslimanë!”³⁷

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿ إِنَّا أَنْزَلْنَا التَّوْرَةَ فِيهَا هُدًى وَنُورٌ يَحْكُمُ بِهَا النَّبِيُّونَ الَّذِينَ أَسْلَمُوا لِلَّذِينَ هَادُوا ... ﴾

“Ne kemi dërguar Tevratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, profetët që ia kishin nënshtruar veten Allahut (ishin bërë muslimanë), i gjykonin hebrenjtë;” [Maide, 44]

Ndërkaq, Belkisa kishte thënë: “O Zoti im, me të vërtetë unë e paskam dëmtuar veten dhe tani, bashkë me Sulejmanin i dorëzohem Allahut - Zotit të botëve (bëhem muslimane)!”³⁸

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿ وَإِذْ أَوْحَيْتُ إِلَى الْحَوَارِيِّينَ أَنْ آمِنُوا بِي وَبِرَسُولِي قَالُوا آمَنَّا وَاشْهَدْ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴾

“... dhe se si kur i urdhërova dishepujt: “Besomëni Mua dhe të Dërguarit Tim!” - ata u përgjigjën: “Ne besojmë, prandaj dëshmo se jemi bërë muslimanë (të nënshtruar ndaj Teje)!” [Maide, 111]

³⁶ Surja Jusuf, 101.

³⁷ Surja Junus, 84.

³⁸ Surja Neml, 44.

Allahu po ashtu ka thënë:

﴿إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ﴾

“Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami.” [Ali Imran, 19]

Dhe ka thënë:

﴿وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ﴾

“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.” [Ali Imran, 85]

I Lartësuar po ashtu ka thënë:

﴿أَفَغَيْرَ دِينِ اللَّهِ يَبْتَغُونَ وَلَهُ أَسْلَمَ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ طَوْعًا وَكَرْهًا وَإِلَيْهِ يُرْجَعُونَ﴾

“A mos kërkojnë ata diçka tjetër përveç fesë së Allahut, ndërkohë që Atij i përgjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?! ” [Ali Imranë, 83]

Pra, Allahu i Lartësuar përmend se të gjitha krijesat janë muslimanë (të nënshtruar ndaj Tij) - me dashje ose pa dashje – sepse të gjitha krijesat e adhurojnë Atë me adhurim të përgjithshëm, pa marrë parasysh a e pohon këtë dikush apo e mohon, ata janë të nënshtruar ndaj Allahut, të menaxhuar prej Tij, që i bie se janë muslimanë, me ose pa dashje, rrjedhimisht, asnjë krijesë nuk ka mundësi të dalë prej asaj që Allahu do për të, që ia ka caktuar në të kaluarën apo pritet t’i ndodhë në të ardhmen, s’ka forcë e as ndryshim përveçse me Të, dhe vetëm Ai është Zoti i gjithësisë dhe Pronari absolut i tyre, vepron çfarë të dojë me ta, ngase është vetë Ai që i ka krijuar, i ka shpikur prej asgjëje dhe i ka formësuar. Çdo tjetër pos Tij është e zotëruar, e mbaruar, e shpikur, e varfër,

nevojtare, e nënshtruar, e mposhtur, ndërsa Ai - qoftë i Lartësuar! - është i Vetmi, Mposhtësi, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi.

Allahu, ndonëse gjithçka që ka krijuar, e ka krijuar përmes shkaqeve (sebepeve), megjithatë, Ai vetë është krijues i shkakut, përcaktuesi i tij, gjegjësisht, krijesa është e varur plotësisht nga Allahu ashtu sikurse edhe shkak, dhe nuk ekziston ndonjë shkak që është i pavarur në veprën e mirë që e sjell, e as largimin e një të keqe, madje secili shkak ka nevojë për një shkaktar tjetër paraprak që e ndihmon, dhe që e shmang nga faktori i kundërt që mundohet ta ndalojë dhe ta privojë nga funksionimi. Ai, i Lartësuar, është i Vetmi që është i Pavarur nga çdo gjë tjetër pos Tij, nuk ka nevojë për një ortak që ta ndihmojë, e as ka dikush që i kundërvihet dhe e privon nga diçka. Për këtë, Allahu ka thënë:

﴿قُلْ أَفَرَأَيْتُمْ مَا تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ أَرَادَنِيَ اللَّهُ بِضُرٍّ هَلْ هُنَّ كَاشِفَاتُ ضُرِّهِ أَوْ أَرَادَنِيَ بِرَحْمَةٍ هَلْ هُنَّ مُمْسِكَاتُ رَحْمَتِهِ قُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ عَلَيْهِ يَتَوَكَّلُ الْمُتَوَكِّلُونَ﴾

“Thuaju: “Si mendoni, nëse Allahu dëshiron të më shkaktojë ndonjë dëm, a mund ta largojnë atë idhujt që ju i adhuron krahas Tij?! Po nëse Ai dëshiron të më mëshirojë, a mund ta pengojnë ata mëshirën e Tij?!” Thuaju: “Mua më mjafton Allahu. Tek Ai le të mbështeten ata që kërkojnë mbështetje.” [Zumer, 38]

Dhe ka thënë:

﴿وَإِنْ يَمْسَسْكَ اللَّهُ بِضُرٍّ فَلَا كَاشِفَ لَهُ إِلَّا هُوَ وَإِنْ يَمْسَسْكَ بِخَيْرٍ فَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ﴾

“Nëse nga Allahu të godet ndonjë fatkeqësi, atëherë askush përveç Tij nuk mund të të shpëtojë. E, nëse të dhuron ndonjë mirësi, dije se vetëm Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.” [En’am, 17]

Allahu ka cituar mikun e tij (halilin) Ibrahimin ﷺ se ka thënë:

﴿ فَلَمَّا رَأَى السَّمَاسَ بَارِغَةً قَالَ هَذَا رَبِّي هَذَا أَكْبَرُ فَلَمَّا أَفَلَتْ قَالَ يَا قَوْمِ إِنِّي بَرِيءٌ مِّمَّا تُشْرِكُونَ ۖ إِنِّي وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ حَنِيفًا ۖ وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ ۖ وَحَاجَّهُ قَوْمُهُ قَالَ أَتُحَاجُّونِي فِي اللَّهِ وَقَدْ هَدَانِ ۚ وَلَا أَخَافُ مَا تُشْرِكُونَ بِهِ إِلَّا أَن يَشَاءَ رَبِّي شَيْئًا ۖ وَسِعَ رَبِّي كُلَّ شَيْءٍ عِلْمًا ۖ أَفَلَا تَتَذَكَّرُونَ ۖ وَكَيفَ أَخَافُ مَا أَشْرَكْتُمْ وَلَا تَخَافُونَ أَنَّكُمْ أَشْرَكْتُم بِاللَّهِ مَا لَمْ يُنَزَّلْ بِهِ عَلَيْكُمْ سُلْطَانًا ۚ فَأَيُّ الْفَرِيقَيْنِ أَحَقُّ بِالْأَمْنِ ۚ إِن كُنتُمْ تَعْلَمُونَ ۖ الَّذِينَ آمَنُوا وَلَمْ يَلْبِسُوا إِيمَانَهُمْ بِظُلْمٍ أُولَٰئِكَ لَهُمُ الْأَمْنُ وَهُمْ مُّهْتَدُونَ ۖ ﴾

“Kur vërejtë Diellin duke lindur, ai thërriti: “Ky është Zoti im, ky është më i madhi!” Por, pasi dielli perëndoi, ai tha: “O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni Allahut në adhurim! Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët”! Dhe, kur populli i tij polemizoi me të, ai tha: “Doni të polemizoni me mua për Allahun, ndërkohë që Ai më ka udhëzuar në rrugën e drejtë?! Unë nuk i kam frikë idhujt tuaj, sepse vetëm po të dojë Zoti im, ata mund të më lëndojnë. Zoti im, me dijeninë e vet ka përfshirë çdo gjë. A nuk po mendoni? E si të frikësohem nga zotat tuaj të remë, ndërkohë që ju nuk keni frikë t’i shoqëroni Allahut idhuj, për të cilët Ai nuk ju ka zbritur kurrfarë argumenti?! Cili nga ne e meriton të jetë i sigurt? Më thoni, nëse njihni të vërtetën! Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari), pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar.” [En’am, 78-82]

Në dy librat e saktë të hadithit (Buhari dhe Muslim), në hadithin që e transmeton Abdullah ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), thuhet se kur u shpall ajeti i mësipërm, shokëve të Pejgamberit ﷺ u erdhi rëndë, andaj thanë: “O i Dërguari i Allahut, po cili prej

nesh nuk i bën padrejtësi vetes?" Pejgamberi ﷺ në atë rast u tha: *"Nuk është ashtu si po mendoni. Fjala është për shirkun. A nuk e keni dëgjuar çfarë i ka thënë Lukmani birit të vet, teksa e këshillonte: **"O biri im, mos i bëj shirk Allahut! Me të vërtetë, shirku është padrejtësia më e madhe."** (Lukman, 13)?"*³⁹

E kur jemi te Ibrahim, ﷺ miku i Allahut (halili), ai ishte babai i besimtarëve të drejtë (hunefaë) dhe të sinqertë.

³⁹ Buhariu, 3429; Muslimi, 124; Ahmedi, 3589; Tirmidhiu, 3069; Ibn Xheriri, 1476.

Përfundim

Dhe si përfundim, mund të themi se dini (feja) islam i ka dy baza:

E para: Mos të adhurojmë dikë tjetër me Allahun e Lartësuar, dhe

E dyta: Adhurimi që i bëjmë Allahut të jetë në përputhshmëri të plotë me atë që Ai ka përcaktuar (shariat), e mos ta adhurojmë me bidate (risi). Siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا﴾

“Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!” [Kehf, 110]

Pikërisht ky është realizimi i dy dëshmimeve (shehadeteve): Shehadeti “la ilahe ilAllah” (s’ka të adhuruar të denjë përveç Allahut) dhe shehadeti “Muhamedun rasulullah” (Muhamedi është i Dërguari i Allahut).

Pra, në të parën: Të mos adhurojmë dikë tjetër pos Tij, kurse në të dytën: se Muhamedi ﷺ është i Dërguari i Allahut i cili ka përçuar mesazhin e Tij, andaj na përket që t’i besojmë lajmit që na sjellë, dhe ta zbatojmë urdhrin e tij. Pejgamberi ﷺ na ka sqaruar se me çfarë duhet ta adhurojmë Allahun dhe na ka ndaluar nga shpikjet në fe, dhe na paralajmëruar se një gjë e tillë është devijim (humbje).

Ndërsa Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿بَلَىٰ مَنْ أَسْلَمَ وَجْهَهُ لِلَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ فَلَهُ أَجْرُهُ عِنْدَ رَبِّهِ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ﴾

“Vërtet, ata që i përgjigjen Allahut dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.” [Bekare, 112]

Sikur që jemi të urdhëruar që të mos i frikohemi askujt tjetër pos Allahut, të mos mbështetemi tek dikush tjetër pos tek Ai, kur të dëshirojmë diçka, të dëshirojmë për hir të Allahut e kur të urrejmë, të urrejmë vetëm për hir të Tij, si dhe kur të na nevojitet ndihmë, ta kërkojmë vetëm prej Allahut, në mënyrë që i tërë adhurimi ynë të bëhet për Allahun e Lartësuar; Ashtu jemi, në anën tjetër, të obliguar që ta pasojmë besnikërisht rrugën e Pejgamberit, ﷺ t'i bindemi e ta zbatojmë atë me të cilën na ka urdhëruar. Me fjalë të tjera, çdo gjë të cilën Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë bërë hallall, ne e konsiderojmë hallall, kurse çdo gjë që e ka bërë haram, e konsiderojmë haram; që do të thotë se e gjithë feja është vetëm aq sa Allahu e ka ligjësuar.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَلَوْ أَنَّهُمْ رَضُوا مَا آتَاهُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَقَالُوا حَسْبُنَا اللَّهُ سَيُؤْتِينَا اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ وَرَسُولُهُ إِنَّا إِلَى اللَّهِ رَاغِبُونَ﴾

“Sikur ata të kënaqeshin me atë që u ka dhënë Allahu dhe i Dërguari i Tij, do të thoshin: “Na mjafton Allahu! Allahu do të na japë nga mirësitë e Veta; edhe i Dërguari i Tij. Ne vetëm tek Allahu i varim shpresat”. [Tevbe, 59]

Pra, Allahu ka legjitimuar që dhënia t'i atribuohet si Allahut, ashtu edhe të Dërguarit të Tij. ﷺ Siç ka thënë edhe në suren Hashr, ajeti 7:

﴿وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا﴾

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.”

Kurse, kur kemi të bëjmë me tevekulin (mbështetjen), Allahu ka urdhëruar që vetëm tek Ai të mbështetemi, kur ka thënë: **“(sikur) të thoshin: “Na mjafton Allahu!”** [Tevbe, 59], e nuk e ka

përmendur këtu Pejgamberin ﷺ. Njëjtë e ka përshtuar edhe gjendjen e sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) të cilët thoshin:

﴿الَّذِينَ قَالَ لَهُمُ النَّاسُ إِنَّ النَّاسَ قَدْ جَمَعُوا لَكُمْ فَاخْشَوْهُمْ فَزَادَهُمْ إِيمَانًا وَقَالُوا
حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ﴾

“(Shpërblim kanë edhe ata) të cilëve njerëzit (hipokritë) u thanë: “Shumë njerëz po mbledhen kundër jush, prandaj frikësohuni!” e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: “Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!” [Ali Imranë, 173]

Po ashtu, Allahu ka thënë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ حَسْبُكَ اللَّهُ وَمَنِ اتَّبَعَكَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ﴾

“O Profet! Allahu të mjafton ty dhe besimtarëve që të pasojnë.” [Enfalë, 64] Pra, të mjafton ty Allahu, dhe u mjafton edhe besimtarëve.

Kurse në një ajet tjetër Allahu thotë:

﴿الَّذِينَ يَكْفَى اللَّهُ عِبْدَهُ﴾

“A nuk i mjafton Allahu robët të Vet?!” [Zumer, 36]

Pastaj thanë: “Allahu do të na japë nga mirësitë e Veta; edhe i Dërguari i Tij.” [Tevbe, 59] Në këtë pjesë të ajetit (që u përmend më lart) dhënia iu atribuua si Allahut, ashtu edhe Pejgamberit të Tij ﷺ, duke i dhënë përparësi përmendjes së mirësisë nga ana e Allahut, për shkak se e tërë mirësia është në Duart e Allahut, ia jep kujt të dëshirojë, se Allahu është zotërues i mirësive të shumta (madhështore), e po ashtu, mirësia e Tij bie edhe mbi të Dërguarin e Tij ﷺ e mbi besimtarët.

E në fund të ajetit të sures Tevbe, Allahu tha: **“Ne vetëm tek Allahu i varim shpresat.”** [Tevbe, 59], duke theksuar se vetëm tek Allahu duhet të shpresohet dhe të kërkohet mirësia. Pejgamberi ﷺ njëherë i pati thënë Ibn Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me të!): *“Kur të lypësh, lypi Allahut e, kur të kërkosh ndihmë, kërkë nga Allahu!”* Kështu pra, Allahu ka bërë ibadetin, frikën dhe devotshmërinë, të veçanta vetëm për Allahun, kurse bindjen (dëgjimin) dhe dashurinë i ka bërë të përbashkëta, për Allahun dhe për Pejgamberin, siç ka cituar fjalën e Nuhut ﷺ:

﴿ أَنْ اعْبُدُوا اللَّهَ وَانْقُضُوا عَهْدَ بَنِي إِسْرَءِيلَ ﴾

“Të adhuronit Allahun, t’i frikësoheni Atij e të më bindeni mua.” [Nuh, 3]

Kurse në ajetin tjetër ka thënë:

﴿ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَخْشَ اللَّهَ وَيَتَّقْهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الْفَائِزُونَ ﴾

“Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që kanë frikë nga Allahu e i përkushtohen Atij, do të jenë të fituarit e vërtetë.” [Nur, 52]

Nga se u tha, kuptuam se të gjithë pejgamberët paskan qenë të urdhëruar që vetëm Allahut t’i bëjnë ibadet, vetëm tek Ai t’i varin shpresat, vetëm Atij t’i mbështeten dhe t’i binden Atij. Pastaj shejtani ua humbi rrugën të krishterëve dhe të tjerëve të ngjashëm me ta, të cilët i përshkruan ortak Allahut dhe i kundërshtuan të Dërguarit e Tij, duke i marrë për zota ahbarët dhe ruhbanët e tyre, si dhe Isain ,ﷺ të birin e Merjemes, duke i varur shpresat tek ta në vend të Allahut dhe duke u mbështetur tek ata (në zgjidhjen e problemeve), duke i lutur ata përkundër kundërshtimit të urdhrave të tyre dhe mospasimit të rrugës së tyre. Pastaj Allahu i Lartësuar i udhëzoi besimtarët e sinqertë të Tij, ata që pasuan rrugën e drejtë, të cilët e njohën të vërtetën dhe e pasuan, duke u shmangur prej atyre mbi të

Përfundim

cilët ka rënë hidhërimi i Allahut (hebrenjve) dhe kanë humbur (të krishterëve), ata të cilët ia kushtuan fenë e tyre vetëm Allahut, i nënshtruan fytyrat e tyre për Allahun, u kthyen kah Ai me pendim, e deshën vetëm Atë, shpresuan vetëm tek Ai, iu frikësuan vetëm Atij, iu lutën vetëm Atij dhe i varën shpresat e tyre vetëm tek Ai, çështjet e tyre ia besuan vetëm Allahut, iu mbështetën vetëm Atij, iu bindën të dërguarve të Tij, i madhëruan dhe i ngritën lart pejgamberët e Tij, i deshën ata, i shoqëruan ata, i pasuan ata, i ndoqën hapat e tyre dhe u ndriçuan me dritën e tyre.

Ky pra është dini Islam, kjo fe me të cilën Allahu i Lartësuar i dërgoi të gjithë pejgamberët e Tij, të parët e të mbramët, dhe kjo është feja përveç të cilës Allahu nuk pranon fe tjetër nga askush. Ky pra është realiteti i adhurimit të Zotit të botëve.

Andaj, e lusim Allahun e Madhërishëm që të na forcojë këmbët në këtë fe dhe të na e plotësojë përkushtimin tonë për të, të na bëjë të vdesim në të, ne dhe të gjithë vëllezërit tanë besimtarë.

Lavd i qoftë Allahut, të Vetmit! Paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi zotërinë tonë Muhamedin ,ﷺ familjen dhe shokët e tij!

* * *